VENDIM
Nr. 93, datë 5.2.2020

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SUEDISË, NË LIDHJE ME PLANIFIKIMIN E SEKTORIT TË UJIT PËR NEGOCIATAT ME BE-në

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Suedisë, në lidhje me planifikimin e sektorit të ujit për negociatat me BE-në, me një grant në shumën 20 000 000 (njëzet milionë) SEK, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

MARRËVESHJE GRANTI
NDËRMJET SUEDISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË LIDHJE ME PLANIFIKIMIN E SEKTORIT TË UJIT PËR NEGOCIATAT ME BE-në
Kontributi i Sida-s nr. 13092A0101

Tabela e përmbajtjes

1. Fusha e veprimit dhe historiku
2. Objektivat e Projektit
3. Zbatimi
4. Granti
5. Disbursimet
6. Menaxhimi financiar
7. Raportimi financiar
8. Raportimi shpjegues
9. Prokurimi
10. Monitorimi
11. Konsultimet dhe takimet e vlerësimit
12. Vlerësimet
13. Auditimet
14. Shlyerjet e interesit, fitimet nga këmbimet valutore dhe fondet e papërdorura
15. Korrupsioni dhe parregullsitë e tjera
16. Masat kompensuese
17. Vizibiliteti dhe informacioni
18. Referenca ndaj marrëveshjeve të tjera
19. Përfundimi
20. Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes
21. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve
22. Njoftimet

Kjo Marrëveshje granti (Marrëveshja) ka hyrë në fuqi ndërmjet:

1. Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë ("Marrësi")

dhe

2. Suedisë, të përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar ("Suedia"),

për forcimin e planifikimit të sektorit të ujit për negociatat me BE-në,

së bashku të referuara si Palët.

1. **Fusha e veprimit dhe historiku**

1.1 Në vitin 2006 Shqipëria dhe Suedia kanë lidhur një marrëveshje për termat e përgjithshëm dhe kushtet për bashkëpunimin e zhvillimit. Suedia aktualisht ka vendosur të japë një grant që do të përdoret ekskluzivisht për zbatimin e Projektit "Planifikimi i sektorit të ujit për negociatat me BE-në". Projekti do të zbatohet gjatë një periudhe 36-mujore, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

1.2 Palët kanë rënë dakord për të lidhur një Marrëveshje, e cila përbëhet nga këto kushte të veçanta dhe shtojcat e mëposhtme, ku të gjitha janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje dhe janë renditur sipas një rendi përparësie. Në rast mospërputhjesh midis kushteve specifike dhe shtojcave, kushtet specifike do të kenë përparësi.

Shtojcat:

A. Dokumenti i Projektit që përshkruan Projektin

B. Buxheti i Projektit.

C. Termat standardë të referencës së Sida-s për auditimin vjetor.

2. **Objektivat e Projektit**

2.1 Objektivi i përgjithshëm i Projektit është të zhvillojë kapacitete strategjike planifikuese në sektorin e ujit për zbatimin e standardeve të BE-së, siç përshkruhet në dokumentin e Projektit "Planifikimi i sektorit të ujit për negociatat me BE-në" të muajit maj 2019, shtojca 1.

2.2 Dokumenti i Projektit, duke përfshirë Kuadrin e Rezultateve, si dhe buxhetin në monedhën euro, mund të përditësohet përmes ndryshimeve me shkrim, sa herë që kërkohen ndryshime të rëndësishme për zbatim efektiv.

3. **Zbatimi**

3.1 Marrësi, nëpërmjet MIE-s, do të jetë plotësisht përgjegjës për zbatimin e Projektit dhe për menaxhimin e kontributeve financiare nga Suedia. Si financues, Suedia nuk mban asnjë përgjegjësi dhe/ose detyrim ndaj ndonjë pale të tretë në lidhje me zbatimin e Projektit.

3.2 Marrëveshjet institucionale dhe të tjera.

3.2.1 Marrësi do të sigurojë që AKUM-i të kryejë aktivitetet e Projektit në përputhje me këtë Marrëveshje.

3.2.2 Marrësi do të sigurojë që gjatë gjithë zbatimit të Projektit, AKUM-i të kryejë aktivitete që i janë lënë në mirëbesim me mbështetje sipas nevojës, duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

3.2.3 Do të përgatitet një Manual Operacional dhe do të specifikojë në detaje të gjitha marrëveshjet institucionale dhe marrëveshjet e tjera zbatuese. Marrësi do t'i dërgojë Manualin Operacional Suedisë brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Grantit. Manuali Operacional do të rishikohet dhe do të përditësohet sipas nevojës.

3.2.4 Marrësi do t'i paraqesë Suedisë, përmes AKUM-it, një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet AKUM-it dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për zbatimin e këtij projekti, jo më vonë se një muaj pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi.

4. **Granti**

4.1 Sida merr përsipër të financojë Projektin përmes një granti deri në një shumë maksimale 20 000 000 SEK (njëzet milionë krona suedeze, Granti) në bazë të alokimeve nga Parlamenti Suedez.

4.2. Granti do të përdoret ekskluzivisht për të financuar kostot aktuale të zbatimit të Projektit

gjatë periudhës së zbatimit. Kostot e paparashikuara që duhet të mbulohen nga fondi i kontigjencës i nënshtrohen miratimit të Suedisë.

4.3 Marrësi, përmes AKUM-it, është përgjegjës për marrjen e burimeve shtesë që mund të kërkohen për zbatimin e duhur të Projektit. Kjo do të pasqyrohet në buxhet dhe do të përfshihet në raportim.

5. **Disbursimet**

5.1 Disbursimet janë të kushtëzuara nga plotësimi i kushteve në këtë Marrëveshje, progresi në lidhje me objektivat e Projektit dhe rezultatet e pritshme, çdo fond i papërdorur në datën e kërkesës së disbursimit, si dhe nga nevojat aktuale financiare në përputhje me planet e punës dhe buxhetet vjetore të paraqitura.

5.2 Suedia do të synojë të sigurojë parashikueshmërinë e financimit të saj, duke lidhur angazhimet e saj vjetore financiare dhe disbursimet me ciklin buxhetor të Marrësit dhe nevojat e fluksit të parave të AKUM-it.

5.3 Granti do të disbursohet në këste gjysmëvjetore (gjashtëmujore) bazuar në nevojën financiare të Projektit për periudhën e ardhshme. Nevoja financiare u referohet shpenzimeve të buxhetuara për periudhën e ardhshme, pa fondet që vihen në dispozicion të Projektit nga të gjitha burimet e tjera gjatë së njëjtës periudhë.

5.4.1 Fondet e siguruara nga Suedia do të paguhen me këste pasi Suedia të marrë dhe të miratojë kërkesat me shkrim për pagesa të nënshkruara nga përfaqësuesi (përfaqësuesit) i/të autorizuar i/të Marrësit, siç përcaktohet në pikën 5.4.2 më poshtë.

5.4.2 Ambasadës do t'i dërgohet një kërkesë me shkrim me informacion mbi titullin e Marrëveshjes dhe numrin e identifikimit (ID) të kontributit, siç specifikohet në parathënien e kësaj Marrëveshjeje.

Kërkesa nënshkruhet nga përfaqësuesit e autorizuar të emëruar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë.

Shuma e kërkuar do të paraqitet në monedhën e krona suedeze (SEK), pavarësisht se në cilën monedhë do të kryhet pagesa. Pagesa do të kryhet në monedhën e preferuar, siç përcaktohet nga Përfituesi në kërkesë.

a) Pagesa do të kryhet në një monedhë të konvertueshme, përveç SEK, me kusht që të jetë shprehur qartë në kërkesë dhe me kusht që llogaria të mund të marrë monedhën e treguar. Kursi i këmbimit të SEK do të bëhet nga banka e Sida-s pas udhëzimeve të pagesës nga Sida.

Të dhënat e mëposhtme të plota të bankës duhet të përfshihen në kërkesë:

- emri i bankës;
- mbajtësi i llogarisë bankare;
- numri i llogarisë bankare;
- IBAN-i (nëse është e zbatueshme);
- kodi SWIFT/Bic;
- monedha e llogarisë.

5.4.3 Kërkesa e parë shoqërohet me një letër të dërguar nga banka për Sida-n, letër e cila përmban dhënien e detajeve të bankës të shprehura më lart.

Kërkesat e mëvonshme për disbursim duhet të shoqërohen me letra të reja bankare vetëm nëse Marrësi ka bërë ndonjë ndryshim në lidhje me ndonjë nga detajet e mësipërme të bankës.

5.5 Pagesa e parë e 3 MSEK do të depozitohet në llogarinë (llogaritë) e caktuar/a bazuar në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

5.6 Pagesat pasuese do të kryhen bazuar në kërkesat e raportimit në këtë Marrëveshje, si dhe në nevojat për likuiditet, sipas planeve të punës dhe buxheteve vjetore të paraqitura.

5.7 Fondet e siguruara nga Suedia do të disbursohen nga Suedia në një llogari të veçantë në Bankën e Shqipërisë në emër të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Marrësi, përmes AKUM-it, do të njoftojë me shkrim Suedinë për marrjen e fondeve. Deklarata do të përfshijë shumën e marrë në monedhën në të cilën janë marrë paratë, si dhe shumën ekuivalente të kredituar në monedhën vendase.

5.8 Marrësi, përmes AKUM-it, konfirmon që financimi i dhënë nga Suedia do të përdoret ekskluzivisht për të mbuluar shpenzimet e alokuara për Projektin, siç përshkruhet në dokumentin e Projektit.

6. Menaxhimi financiar

Marrësi, përmes AKUM-it, do të sigurojë për Projektin një sistem të përshtatshëm të administrimit financiar, në përputhje me legjislacionin kombëtar, siç zbatohet nga administrata publike në Shqipëri.

Të ardhurat dhe kostot që kanë lidhje me Projektin, duhet të jenë lehtësisht të identifikueshme dhe të verifikueshme.

Kostot duhet të jenë të paraqitura në buxhetin e përgjithshëm të vlerësuar dhe të jenë të nevojshme për zbatimin e projektit.

7. Raportimi financiar

7.1 Përfituesi, përmes AKUM-it, do t'i përgatisë dhe dorëzojë Suedisë pasqyrat financiare dhe raportet financiare gjysmëvjetore për Projektin jo më vonë se datat 31 mars dhe 30 shtator të çdo viti. Raporti i parë financiar që mbulon vitin 2019 do të dorëzohet jo më vonë se data 31 mars 2020. Raporti përfundimtar financiar do të përfshijë periudhën 1 korrik 2019 deri më 31 dhjetor 2022 dhe do të dorëzohet jo më vonë se data 30 qershor 2022.

7.2 Raporti financiar gjysmëvjeçar do të përfshijë periudhat nga 1 janar deri më 30 qershor dhe nga 1 korrik deri më 31 dhjetor. Pasqyrat financiare/raportet financiare përfshijnë të ardhurat dhe kostot aktuale në krahasim me buxhetin e miratuar për periudhën raportuese dhe do të tregojnë financimin nga Suedia, në atë formë dhe detaje që lejojnë identifikimin e disbursimeve në Projektin e rënë dakord.

Pasqyrat financiare/raportet financiare do të nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm i AKUM-it.

7.3 Pasqyrat financiare dhe raportet financiare gjysmëvjetore përfshijnë informacione mbi shumën e marrë, si në monedhën e transferimit, ashtu edhe shumën në monedhën vendase, kursin e këmbimit dhe informacion mbi datën kur është kredituar shuma.

7.4 Raporti do të përfshijë, gjithashtu, informacione mbi shpenzimet totale, të ndara në përputhje me zërat e buxhetit të rënë dakord për periudhën raportuese, si dhe shumat kumulative për të gjithë periudhën e projektit.

8. Raportimi shpjegues

8.1 Marrësi, përmes AKUM-it, do t'i dërgojë Suedisë një raport shpjegues, me shkrim, gjysmëvjetor, jo më vonë se datat 31 mars dhe 30 shtator çdo vit.

8.2 Raporti shpjegues do të përmbajë një analizë të progresit të aktiviteteve të projektit dhe rezultateve të pritshme, sipas strukturës së dokumentit të Projektit (kuadri i rezultateve, siç shtjellohet më tej në planet gjysmëvjetore të punës).

8.3 Raporti gjysmëvjetor do të mbulojë periudhat nga 1 janar deri më 30 qershor dhe nga 1 korrik deri më 31 dhjetor. Raporti gjysmëvjetor do të përmbajë një llogari mbi bazë kumulative që mbulon të gjithë periudhën e projektit, të:

- aktiviteteve të kryera gjatë periudhës së raportimit;
- rezultateve të arritura kundrejt rezultateve të planifikuara;
- objektivave të rezultateve të arritura kundrejt objektivit (objektivave) të rezultatit të planifikuar ose ecurisë drejt arritjes së objektivit (objektivave) të rezultatit dhe një vlerësim të mundësive për arritjen e objektivave të planifikuar;
- një vlerësimi të faktorëve të riskut që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave; dhe
- një vlerësimi të rregullimeve të mundshme në zbatimin e Projektit, duke përfshirë menaxhimin e riskut.

8.4 Marrësi, përmes AKUM-it, do t'i dërgojë me shkrim Suedisë, jo më vonë se gjashtë muaj pas datës së mbylljes së projektit, një raport përfundimtar. Raporti përfundimtar do të përmbajë një llogari në bazë kumulative që mbulon të gjithë periudhën e veprimtarisë, të:

- rezultateve të arritura kundrejt rezultateve të planifikuara;
- objektivit (objektivave) të rezultateve të arritura kundrejt objektivit (objektivave) të rezultatit të planifikuar;
- të një vlerësimi të faktorëve që kanë pasur ndikim tek arritja e objektivave;
- mësimeve të nxjerra nga zbatimi i Projektit; dhe
- të një vlerësimi të nevojave të mundshme për rregullime në një fazë të re potenciale të Projektit, duke përfshirë veprimet për zbutjen e riskut.

8.5 Marrësi, përmes AKUM-it, do të ofrojë të gjitha informacionet e tilla të rëndësishme për zbatimin e Projektit, siç mund të kërkohet nga Suedia.

9. Prokurimi

Marrësi, përmes AKUM-it, do të prokurojë të gjithë artikujt e kërkuar për Projektin dhe në përputhje me udhëzimet e PRAG-ut, "Prokurimet dhe grantet për veprimet e jashtme të Bashkimit Evropian – Një udhëzues praktik", në zbatim që nga data 2 gusht 2018". Hapat e mëposhtëm të procedurave të prokurimit dhe marrëveshjeve të zbatimit do të kërkojnë miratim paraprak nga Suedia:

- termat e referencës dhe specifikimet teknike për të gjitha aktivitetet e Projektit;
- raporti vlerësues që përfshin pjesët teknike dhe financiare dhe;
- çdo shtesë kontrate e cila do të rriste vlerën e kontratës.

Manuali i Operimit do të përshkruajë në detaje rregullat e prokurimit dhe përgjegjësitë e Suedisë, AKUM-it dhe MIE-s.

10. Monitorimi

10.1 Marrësi, përmes AKUM-it, është përgjegjës për monitorimin e ecurisë dhe performancës së Projektit dhe arritjen e rezultateve dhe produkteve të pritshme.

10.2 Suedia do të monitorojë pajtueshmërinë dhe ecurinë bazuar në këtë Marrëveshje.

10.3 Procesi i inspektimit të ecurisë së zbatimit të Projektit do të harmonizohet me procesin e inspektimit të Marrësit.

10.4 Marrësi, përmes AKUM-it, dhe Suedia do të mbajnë një dialog të ngushtë në lidhje me mbështetjen dhe zbatimin e Projektit.

11. **Takimet konsultative dhe vlerësuese**

11.1 Palët do të bashkëpunojnë dhe do të komunikojnë rregullisht me njëra-tjetrën për të gjitha çështjet që kanë lidhje me zbatimin e Projektit dhe këtë Marrëveshje.

11.2 Palët do të takohen çdo 6 muaj për të diskutuar mbi zbatimin e Projektit. Takimet do të thirren dhe drejtohen nga AKUM-i.

11.3 Kostoja e takimeve do të përballohet nga buxheti i Projektit.

11.4 Temat kryesore për t'u diskutuar gjatë konsultimeve përfshijnë:

- rezultatet/progresin e arritur, duke përfshirë zhvillimin e kapacitetit të institucioneve shqiptare;
- planin e punës për periudhën vijuese;
- çdo kërkesë për ndryshim të termave të referencës ose kontratës;
- veprimet e ndërmarra për të koordinuar zbatimin e projektit me aktivitete të tjera që kanë lidhje me të (p.sh., aktivitete të tjera të mbështetura nga donatorët);
- vendimet e marra;
- integrimi i barazisë gjinore dhe çështjeve të tjera të integrimit;
- pjesëmarrja dhe konsultimi me palët e interesuara vendore si bashkitë, ndërmarrjet publike dhe CSO-të.

11.5 Rezultati i takimit do të regjistrohet në procesverbal për të cilin bihet dakord. Procesverbali i dakordësuar do të hartohet nga AKUM-i dhe një draft do t'i dërgohet Suedisë, për miratim dhe komente, brenda dy javësh pas takimit. Suedia do të informojë Marrësin për miratimin dhe komentet e tij brenda 10 ditëve nga marrja e draftit.

11.6 Marrësi, përmes AKUM-it, ose Suedia mund të kërkojnë takime konsultative shtesë për ndonjë temë që ka rëndësi për zbatimin e Projektit.

11.7 Marrësi, përmes AKUM-it, do të informojë menjëherë Suedinë për çdo rrethanë që mund të ndikojë ose që rrezikon të ndikojë në zbatimin e suksesshëm të Projektit dhe për ndryshime të tjera, dhe me qëllim zgjidhjen e çështjes do të thërrasë një takim për të informuar dhe për t'u konsultuar me Suedinë mbi veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren, nëse ka.

12. Vlerësimet

12.1 Nëse Suedia kryen një vlerësim shtesë, të përkohshëm ose *ex post* ose një mision monitorimi, Marrësi, përmes MIE-s, do të marrë përsipër të sigurojë çdo dokument ose informacion që do të ndihmojë vlerësimin ose misionin e monitorimit dhe do të japë të drejta aksesi siç përshkruhet në këtë marrëveshje.

12.2 Nëse secila Palë kryen ose ndërmerr një vlerësim gjatë projektit, ajo duhet të informojë paraprakisht Palën tjetër dhe t'i sigurojë Palës tjetër një kopje të raportit të vlerësimit.

12.3 Kostoja e vlerësimit të kërkuar apo të kryer nga Suedia do të mbulohet nga Suedia.

13. Auditimet

13.1 Auditimet e jashtme paguhen nga Projekti dhe kryhen nga një audites i jashtëm i pavarur dhe i kualifikuar. Auditimi do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të lëshuara nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI) ose Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC) ose në përputhje me standardet e krahasueshme kombëtare.

13.2 Marrësi, përmes AKUM-it, do t'i dërgojë Suedisë një kopje të raportit të auditimit dhe letrës së menaxhimit, siç janë paraqitur nga firma e auditimit.

13.3 Auditimi kryhet nga një audites i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar. Do të përdoren si referencë termat standardë të referencës së Sida-s për auditimin financiar, aneksi C, dhe termat përfundimtarë të referencës do të miratohen nga Suedia. Raporti i auditimit, përfshirë letrën e menaxhimit, do t'i dërgohen Suedisë jo më vonë se data 31 mars e çdo viti.

13.4 Nëse auditimi jep ndonjë rekomandim, Marrësi, përmes AKUM-it, do t'i dërgojë Suedisë brenda tri javësh, një përgjigje të menaxhimit, duke përfshirë një plan veprimi.

13.5 Jo më vonë se tre muaj pasi kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, Suedia do të financojë dhe do të kryejë një inspektim të kapaciteteve prokuruese të AKUM-it dhe sistemeve të menaxhimit financiar të këtij projekti. Suedia do t'i dërgojë AKUM-it paraprakisht termat e referencës së këtij inspektimi.

13.6 Suedia në çdo kohë mund të ndërmarrë ose të kërkojë ndonjë auditim shtesë (si auditim të prokurimeve ose auditime me qëllime ligjore), ndjekje të mëtejshme ose studime financiare. Marrësi, përmes AKUM-it, do të bashkëpunojë dhe do të ndihmojë Suedinë në çdo auditim të tillë.

Kostot për auditimet shtesë do të financohen nga Suedia.

14. Shlyerja e interesit, fitimet nga këmbimet valutore dhe fondet e papërdorura

14.1 Në fund të periudhës së aktivitetit, çdo fond i papërdorur që është në total më shumë se 500 SEK, do t'i kthehet Sida-s sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 45 ditë kalendarike pasi Sida të ketë lëshuar një njoftim për shlyerje për Marrësin. Shlyerja përfshin të ardhurat nga interesi, fitimet e këmbimit valutor dhe fitimet e tjera financiare të llogaritura në grant, përveç nëse është rënë dakord ndryshe.

14.2 Marrësi, përmes AKUM-it, është përgjegjës për të siguruar që fondet e dërguara te partnerët zbatues që mbeten të papërdorura në fund të periudhës së aktivitetit, t'i kthehen Sida-s

14.3 Shlyerjet do të bëhen në llogarinë e caktuar bankare të Sida-s për shlyerjet, detajet e së cilës do të sigurohen nga Sida sapo të kërkohen.

14.4 Transaksioni do të shënohet qartë: "Fondet e papërdorura". Do të deklarohet emri i Marrësit, së bashku me numrin e kontributit të Sida-s dhe titullin e marrëveshjes.

15. Korrupsioni dhe parregullsi të tjera

15.1 Palët do të punojnë në mënyrë aktive për të parandaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda Projektit. Ky detyrim vlen për të gjithë anëtarët e stafit, konsulentët dhe personelin tjetër që nuk është staf.

15.2 Korrupsioni dhe parregullsitë e tjera i referohen të gjitha llojeve, të:

a) korrupsionit, duke përfshirë mitmarrjen, nepotizmin, mitmarrjet e paligjshme ose format e tjetra të abuzimit të besimit, pushtetit dhe pozitës për përfitime të papërshtatshme;

b) shpërdorimi i parave, inventarit dhe të gjitha llojeve të tjera të pasurive;

c) deklaratave mashtruese financiare dhe jofinanciare;

d) të gjitha përdorimeve të fondeve që nuk janë në përputhje me planin e punës dhe buxhetin.

15.3 Palët:

a) marrin në konsideratë riskun e korrupsionit dhe parregullsive të tjera gjatë planifikimit dhe zbatimit të Projektit dhe identifikojnë risqet kryesore dhe masat për zbutjen e risqeve. Nëse identifikohet një risk i konsiderueshëm i korrupsionit dhe parregullsive të tjera, do të ndërmerren masa për zbutjen e riskut për të zvogëluar riskun e identifikuar;

b) organizojnë veprimet e tyre dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në mënyrë të tillë që të parandalohet, menaxhohet dhe zbulohet korrupsioni dhe parregullsitë e tjera;

c) bëjnë përpjekje maksimale për të parandaluar dhe ndaluar korrupsionin dhe parregullsitë e tjera brenda projektit;

d) kërkojnë që i gjithë stafi i përfshirë, dhe çdo konsulent, furnitor dhe kontraktues i financuar nga Projekti të shmangë korrupsionin dhe parregullsitë e tjera.

15.4 Marrësi, përmes AKUM-it, do të informojë Sida-n menjëherë për çdo tregues të korrupsionit dhe parregullsive të tjera në ose të lidhura me projektin.

15.5 Marrësi merr përsipër, përmes AKUM-it, të hetojë praninë e korrupsionit dhe parregullsive të tjera dhe të ndërmarrë veprime, përfshirë veprimet juridike, kundër personave për të cilët ka arsye për të dyshuar për korrupsion dhe parregullsi të tjera. Pas kësaj, palët do të vazhdojnë të konsultohen me njëra-tjetrën për trajtimin e mëtejshëm të çështjes.

16. Masat kompensuese

16.1 Në rast mosrespektimi nga ana e Marrësit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, Suedia rezervon të drejtën të ushtrojë mjetet juridike të mëposhtme, përfshirë ndalimin e disbursimeve të mëtejshme dhe/ose uljen e disbursimeve të reja, duke kërkuar shlyerjen e fondeve ose përfundimin e mbështetjes së saj për Projektin.

16.2 Në rast shkeljeje të Marrëveshjes, Suedia mund ta përfundojë Marrëveshjen me një njoftim me afat dymujor.

16.3 Në rast shkeljeje serioze të Marrëveshjes, Suedia mund të përfundojë Marrëveshjen me efekt të menjëhershëm.

16.4 Në rastet e përfundimit nga ana e Suedisë, përfundimi nuk do të zbatohet për fondet e kryera në mënyrë të pakthyeshme në mirëbesim nga Marrësi ndaj palëve të treta përpara datës së njoftimit të përfundimit, me kusht që angazhimet të jenë bërë në përputhje me këtë Marrëveshje.

16.5 Çdo përfundim do të bëhet me një njoftim përfundimi me shkrim.

17. Vizibiliteti dhe informacioni

17.1 Kur iu referohet veprimtarive të financuara plotësisht ose pjesërisht në përputhje me këtë Marrëveshje, Marrësi, përmes AKUM-it, do të njohë dhe bëjë kurdoherë publike se aktivitetet financohen përmes ndihmës suedeze për zhvillim.

17.2 Logoja e Suedisë do të përdoret në prodhimin e materialeve informuese dhe në lidhje me aktivitetet e informacionit.

17.3 Prodhimi/përgatitja i/e materialeve të tilla është plotësisht përgjegjësi e Marrësit dhe përgjegjësia e përmbajtjes i mbetet botuesit. "Sida" ose "Suedia" nuk mund të përdoret në asnjë mënyrë që mund të perceptohet sikur Sida ose Suedia ka marrë pjesë në prodhim ose mbështet ndonjë mendim të paraqitur.

17.4 Sida dhe departamentet e tjera të administratës suedeze jashtë vendit kanë të drejtë të kopjojnë dhe shpërndajnë materiale të tilla, nëse është e nevojshme.

18. Referenca ndaj marrëveshjeve të tjera

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve sipas kësaj marrëveshje udhëhiqet gjithashtu nga:

- Marrëveshja për termat dhe kushtet e përgjithshme të bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet

Palëve për periudhën 30 qershor 2006 deri në përfundimin nga secila palë me njoftimin me shkrim 6 muaj përpara;

- Marrëveshja për bashkëpunim për zhvillim ndërmjet palëve, për periudhën 9 shkurt 2016 deri më 31 dhjetor 2020; dhe

- çdo marrëveshje që mund të zëvendësojë apo të ndryshojë marrëveshjet e lartpërmendura.

19. Përfundimi

19.1 Kjo Marrëveshje do të mbetet e vlefshme deri 36 muaj pas hyrjes në fuqi, përveç nëse përfundon më herët me anë të një njoftimi me shkrim prej gjashtë muajsh nga secila Palë.

19.2 Në rast përfundimi nga ana e Marrësit, nuk do të vihen në dispozicion fonde për aktivitetet pas gjashtë muajve nga lajmërimi me shkrim.

19.3 Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Palëve në përputhje me këtë Marrëveshje do të vazhdojnë të jene të pacenuara deri në kthimin e fondit/fondeve të mbetur/a në Suedi dhe përmbushjen e kritereve të raportimit të kësaj Marrëveshjeje, në atë kohë që përfundon kjo Marrëveshje.

20. Periudha e vlefshmërisë së marrëveshjes

20.1 Marrëveshja do të hyjë në fuqi pas komunikimit me shkrim të Marrësit për përfundimin e procedurave të saj të brendshme dhe do të mbetet e vlefshme deri 36 muaj pas fillimit të saj, përveç nëse përfundon në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose deri në kthimin e ndonjë fondi të papërdorur te Sida dhe përmbushjen e kritereve të raportimit të kësaj Marrëveshjeje, në atë kohë që përfundon kjo Marrëveshje.

20.2 Përfundimi ose mbarimi i afatit i Marrëveshjes nuk do t'i çlirojë Palët nga asnjë përgjegjësi që lind nga ndonjë veprim ose mospërmbushje detyrimi që ka ndodhur para këtij përfundimi ose mbarimi afati.

21. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Nëse lind ndonjë mosmarrëveshje ndërmjet nënshkruesve për interpretimin, aplikimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, ata do të konsultohen me njëri-tjetrin për të arritur një zgjidhje miqësore.

22. **Njoftimet**

Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim, dhe duhet të paraqesë numrin e kontributit të Sida-s dhe titullin e Projektit dhe të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Suedinë:

Ambasada e Suedisë në Tiranë, rr. "Pjetër Budi" 56, Tiranë.

Në vëmendje të Tomas Nystrom.

Për Marrësin:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar në gjuhën angleze në dy kopje origjinale, një për secilin nënshkrues.

Tiranë, 2019-	Tiranë, 2019-
Vendi dhe data	Vendi dhe data
Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida)	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Nënshkrimi	Nënshkrimi
AMBASADOR ELSA HASTAD	MINISTËR ANILA DENAJ

Përfundimtar

MBËSHTETJE PËR NEGOCIATAT DHE PLANIFIKIMIN E INVESTIMEVE TË UJIT
MNPI TË UJIT

PROJEKTPROPOZIM

Përgatitur nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Qeveria e Shqipërisë
Qershor 2019

Përmbajtja

1. Planifikimi strategjik në Sektorin e Ujit
1.1. Direktiva e trajtimit të ujërave të ndotura urbane (91/271/KEE)
1.2. Direktiva e ujit të pijshëm (98/83/KE)
1.3. Kriteret e menaxhimit të llumit
1.4. Ngritja organizative
1.5. Përmirësimi i kapacitetit për zbatimin e kritereve të BE-së që kanë lidhje me ujin dhe planifikimin e infrastrukturës
1.6. Asistenca e vazhdueshme teknike:
2. Objektivat e përgjithshëm:
3. Analiza e supozimeve, risqeve dhe masave zbutëse
4. Kontributet teknike
5. Menaxhimi dhe komunikimi me palët e interesuara
6. Prokurimi
7. Menaxhimi i projektit
8. Çështjet horizontale
9. Buxheti
10. Grafiku i veprimtarive
11. Kuadri logjik

PROJEKTPROPOZIMI

Sektori: Uji
Aktivitetet kryesore: Planifikimi strategjik, përgatitja për negociatat me BE-në, buxheti për ngritje kapacitetesh: SEK 20m/€ 1.87m
Kohëzgjatja: 36 muaj (duke përfshirë prokurimet)

Përfituesi kryesor: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përfituesit e tjerë kyç: Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM)

Planifikimi afatgjatë në sektorin e ujit është thelbësor për të arritur objektivat kombëtarë, për të shfrytëzuar në mënyrë sa më efektive fondet në dispozicion dhe për të tërhequr fonde të mëtejshme. Standardet e BE-së, të transpozuara në ligjin kombëtar, ofrojnë standarde të qarta për t'u përmbushur dhe burime për të ndihmuar në arritjen e përmirësimeve.

Uji i pijshëm dhe trajtimi i ujërave të zeza së bashku mund të përbëjnë më shumë se 60% të kërkesave për investime publike për të gjithë sektorin e mjedisit. Situata ujore e Shqipërisë sugjeron që vendi të përballet me sfida të ngjashme me vendet e tjera kandidate të BE-së dhe gjithashtu mund të arrijë të njëjtin sukses ose më mirë.

Projekti i propozuar do të mbështesë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për të hartuar plane afatgjata, bazuar në përmbushjen e standardeve të BE-së. Nga listat e plota të masave për të arritur pajtueshmërinë, mund të krijohen programe investimesh afatshkurtra, të

cilat do të ofrojnë një bazë të qëndrueshme për ngritjen dhe financimin e kapaciteteve.

1. Planifikimi strategjik në sektorin e ujit

Planifikimi kombëtar i Shqipërisë parashikon katër kategori kryesore për planifikimin e duhur të përdorimit të ujit:

- Ujë për njerëzit, i cili përfshin ujin e pijshëm, trajtimin e ujërave të përdorura dhe rrjetet e kanalizimeve përkatëse;

- Ujë për ushqim për përdorimin e ujit në bujqësi;

- Ujë për industrinë ku uji përdoret për prodhimin e energjisë, aktivitete argëtuese dhe në industri (përfshirë turizmin);

- Ujë për mjedisin që ka lidhje me ndryshimet klimatike, ekosistemet dhe cilësinë dhe sasinë e ujit.

Politika mjedisore dhe klimaterike e BE-së synon të promovojë zhvillimin e qëndrueshëm, ekonominë me karbon të ulët, dhe menaxhimin efikas të burimeve dhe mbrojtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm. Për vende si Shqipëria që i nënshtrohen procesit të integrimit/pranimit në BE, politikat mjedisore dhe klimaterike përfshihen në kapitullin 27 të legjislacionit ose *acquis*. Zbatimi i kapitulli 27 konsiderohet si një nga negociatat më të kushtueshme të kapitullit të BE-së dhe kryesisht për shkak të infrastrukturës së sektorit të ujit, veçanërisht sistemit të mbledhjes dhe trajtimit të ujërave të ndotura që kërkon zhvillim të rëndësishëm të infrastrukturës mjedisore. Identifikimi, zhvillimi dhe zbatimi i projektit kërkon një kohë shumë të gjatë dhe përpjekje të përbashkëta nga institucione të ndryshme. Nevojitet planifikim afatgjatë për të ngritur një proces efikas të administrimit të investimeve në Shqipëri.

Prioritetet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) janë përcaktuar në strategjinë kombëtare të sektorit, masterplanin kombëtar të sektorit dhe gjithashtu në prioritetet e programit qeveritar.

Objektivat strategjikë të Strategjisë Kombëtare Sektoriale të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, 2019–2030 (v20Mar19), janë paraqitur më poshtë:

Objektivat strategjikë	
Objektivi strategjik 1	Përmirësimi i cilësisë, saktësisë dhe qëndrueshmërisë së të dhënave të sektorit të ujit
Objektivi strategjik 2	Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në shërbimet e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve
Objektivi strategjik 3	Përmirësimi i eficiencës dhe cilësisë së shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve
Objektivi strategjik 4	Forcimi i qëndrueshmërisë dhe përballueshmërisë financiare të shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve drejt parimit të rikuperimit të plotë të kostove
Objektivi strategjik 5	Rritja e kapaciteteve të fuqisë punëtore të sektorit
Objektivi strategjik 6	Përmirësimi i drejtimit dhe rregullimit të sektorit
Objektivi strategjik 7	Hartimi dhe zbatimi i një programi për të grupuar ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve

Për planifikimin afatmesëm, treguesit e matshëm për prioritetet kryesore, janë:

- furnizim me ujë të pijshëm për 24 orë për zonat bregdetare turistike;
- furnizim me ujë të pijshëm për 24 orë për zonat e mëdha urbane.

MNPI-ja e ujit, për shkak të kontributit të tij në planifikimin dhe financimin e investimeve të furnizimit dhe ujë dhe ujërave të përdorura, do të jetë i aftë të kontribuojë ndjeshëm në këto qëllime strategjike.

Aktivitetet kryesore përkatëse të financuara nga donatorët për këtë Projekt, janë:

Projektet e GIZ-it në lidhje me shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimeve "Shërbime të furnizimit me ujë dhe kanalizime të orientuara drejt performancës dhe konsumatorit" dhe "Mbështetje për menaxhimin e ujërave (IPA 2016), komponenti 2" në lidhje me punën e tyre në hartimin e legjislacionit, kontratat e nivelit kombëtar-vendor, pronësinë lokale dhe performancën e ndërmarrjeve dhe promovimin e barazisë gjinore në sektor.

Burimet e ujit ADA, BE IPA 16 "Mbështetje për menaxhimin e ujërave (IPA 2016), Komponenti 1" në lidhje me zbatimin e direktivës kuadër të ujit dhe menaxhimin e basenit të lumenjve.

Projektet e KfW-së: BE – IPA 13 "Furnizimi me ujë i zonave rurale III" kryesisht për aksesin

e barabartë në lidhje me ujin dhe çështjet e përballueshmërisë dhe përvoja praktike në zbatimin e IPA 18 "Infrastruktura e bashkive V/performanca e sektorit të ujit dhe Programi", si dhe menaxhimi dhe të dhënat e masterplanit të ujit.

Projektet e Sida-s: "Projekti i mbështetjes për pranimin në BE SANE27" dhe "Mbështetje për krijimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" në lidhje me përgatitjen e pozicionit negociues të Shqipërisë për kapitullin 27 dhe krijimin e AMBU-së.

Për sa i përket koordinimit të përgjithshëm, Grupi i Koordinimit të Donatorëve po punon në mënyrë efektive për të ndjekur projektet e reja ose ndryshime më të zgjeruara. MIE është njëkohësisht drejtuesi i këtij grupi donatorësh dhe udhëheqësi i projektit për MNPI-në e ujit, duke e bërë koordinimin më të lehtë.

Në të njëjtën kohë, niveli i detajeve të nevojshme për hartimin e dokumenteve në bazë të këtij projekti do të kërkojë takime specifike me ekipet teknike të secilit prej projekteve kryesore dhe të të tjerëve pasi ato të bëhen të dukshme. Lidhjet ekzistuese duhet të bëjnë të mundur koordinimin dhe shkëmbimin e informacionit. Ekipi menaxhues i këtij projekti në AKUM është, gjithashtu, partneri kryesor i shumicës së projekteve të KfW-së dhe GIZ-it, Ambasada Suedeze po bashkërendon projektet e SANE-s dhe AMBU-së.

Planifikimi i BE-së bazuar në përputhshmëri: sipas procesit të përafrimit/integrimit në BE, Shqipëria do të duhet të paraqesë veprime për mënyrën sesi do të zbatojë kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës të BE-së, duke përfshirë edhe menaxhimin e ujit. Direktivat më sfiduese janë direktivat e investimeve të mëdha, siç janë: direktiva e trajtimit të ujërave të ndotura urbane dhe direktiva e ujit të pijshëm, të cilat kërkojnë një periudhë më të gjatë zbatimi dhe fonde të mëdha për të arritur zbatim të plotë. Si rrjedhojë, Shqipëria do të kërkojë kohë shtesë për zbatim pas përfundimit të procesit të negociatave të BE-së.

Kërkohet një grup dokumentesh planifikuese specifike për t'u përgatitur për negocimin e kritereve/dispozitave të direktivës së trajtimit të ujërave të ndotura urbane (DTUNU) dhe direktivës së ujit të pijshëm (DUP) – duke qenë parakusht për të kërkuar periudha kalimtare për zbatimin e tyre. Në këtë rast, planet specifike të zbatimit të direktivës duhet të përgatiten me veprime të identifikuara qartë, nevoja për investime dhe mekanizma të propozuar financimi përkatëse për zbatimin e tyre.

1.1 Direktiva e trajtimit të ujërave të ndotura urbane (91/271/KEE)

Direktiva e trajtimit të ujërave të ndotura urbane kërkon identifikimin e grupimeve – zonave ku popullsia dhe/ose aktivitetet ekonomike janë shumë të përqendruara që ujërat e ndotura urbane të mblidhen dhe të përcillen në një impiant për trajtimin e ujërave të ndotura urbane ose në një pikë përfundimtare të shkarkimit.

Niveli i trajtimit të ujërave të ndotura në grupime do të varet nga përcaktimi i zonave sensitive. direktiva e trajtimit të ujërave të ndotura urbane kërkon identifikimin e zonave sensitive, bazuar në kritere specifike për trupat ujorë në kushte eutrofike ose që priren të bëhen eutrofike në të ardhmen. Gjithashtu, kjo direktivë përshkruan kriteret në lidhje me ngarkesën dhe metodën e trajtimit të ujërave të ndotura urbane që shkarkohen në zona sensitive. Këto zona duhet të renditen, ndër të tjera, si zona të mbrojtura në përputhje me direktivën kuadër të ujit të BE-së. Kostot e infrastrukturës dhe identifikimi i prioriteteve për mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane varen nga madhësia e grupimit dhe ndjeshmëria e zonës. Aktualisht, këto dy aspekte shumë të rëndësishme për zbatimin e kritereve të BE-së – identifikimi i grupimeve dhe zonave sensitive – nuk janë realizuar ende në Shqipëri.

1.2 Direktiva e ujit të pijshëm (98/83/KE)

Duke ndjekur të njëjtën qasje si atë për trajtimin e ujërave të ndotura, duhet të identifikohen sistemet e furnizimit me ujë dhe të vlerësohet në dy nivele infrastruktura e nevojshme për furnizimin me ujë të konsumatorëve:

- zonat e shpërndarjes së ujit të pijshëm, të cilat janë të lidhura me burimin e furnizimit me ujë (zonat ujore);
- niveli i grupimit/ndërmarrjeve, i cila ka më shumë lidhje me përgjegjësinë për shërbimin e

furnizimit me ujë, planifikimin dhe zbatimin e projekteve të investimeve, vendosjen e sistemeve të tarifimit etj.

Zonat e shpërndarjes do të përcaktohen kryesisht në bazë të analizës teknike të situatës ekzistuese dhe planeve të zhvillimit për të ardhmen e furnizimit me ujë.

1.3 Kriteret e menaxhimit të llumit

Rritja e nivelit të trajtimit të ujërave të ndotura në Shqipëri do të zvogëlojë ndotjen e ujit që aktualisht po shkaktohet nga shkarkimi i ujërave të ndotura të patrajtuara. Nivelet e rritura të trajtimit të ujërave të ndotura do të prodhojnë sasi të konsiderueshme të llumrave të ujërave të zeza, të cilat duhet të trajtohen në mënyrën e duhur.

Analiza e situatës aktuale ka treguar se trajtohen vetëm 13% e ujërave të ndotura, megjithatë ekziston një plan për ndërtimin e disa impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN) në të ardhmen e afërt që do të gjenerojë llum. Duke marrë parasysh objektet ekzistuese tepër të kufizuara për trajtimin dhe eliminimin e llumit, ekziston rreziku që kjo sasi e re të dërgohet në venddepozitime jo të përshtatshme.

Vendimi i Këshillit të Ministrave (2015) që përcakton kriteret për përdorimin e llumit në bujqësi do të përfaqësonte një opsion të mundshëm për eliminimin e llumit, por nuk trajton çështjen e përgjithshme. Shkarkimi i llumit në venddepozitime nuk ka të ngjarë të pranohet në venddepozitimet e reja rajonale pasi ato të ndërtohen.

Ekziston një nevojë urgjente për të përditësuar politikën e menaxhimit të llumrave në Shqipëri paralelisht me zhvillimin intensiv të shërbimeve të trajtimit të ujërave të ndotura.

1.4 Ngritja organizative

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) kanë role kryesore në planifikimin e infrastrukturës ujore në Shqipëri.

MIE ka përgjegjësi për zhvillimin e politikës për komponentin: uji për njerëzit. Përgjegjësitë në të gjitha institucionet publike janë si më poshtë:

Përgjegjësitë institucionale (uji):

1. Këshilli i Ministrave është organi më i lartë vendimmarrës i qeverisë për të gjitha çështjet thelbësore në lidhje me sektorin e ujit.

2. Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) miraton përparësitë/drejtimet thelbësore të strategjisë së zhvillimit të vendit, strategjitë kombëtare, sektoriale dhe ndërsektoriale, përcakton dhe miraton kuadrin e MTBP-së, merr vendime strategjike për tavanet buxhetore, programet dhe projektet kryesore të investimeve publike në bazë të prioriteteve të qeverisë, realizon koordinimin strategjik të ndihmës së huaj me komunitetin e donatorëve, monitoron dhe vlerëson ecurinë e zbatimit të prioriteteve, programeve, investimeve kryesore dhe riprogramimin e tyre.

3. Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) është organi qendror vendimmarrës, përgjegjës për menaxhimin e burimeve ujore.

4. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është një institucion publik, buxhetor i varur nga Kryeministri, i krijuar me anë të një ligji të veçantë (nr. 6/2018). AMBU-ja është institucioni kryesor qendror përgjegjës për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

5. Ministritë e linjës (MBZHR, MTM, MEI, MShMS, MB) janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën ku objekti i përgjegjësisë së tyre mbivendoset/kryqëzohet me sektorin e ujit dhe menaxhimin e burimeve ujore.

6. Komisionet/Komitetet për organet specifike të ujit që janë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e tyre të përgjegjësisë.

7. Këshillat e Baseneve Ujore (KBU) janë organet vendore përgjegjëse për menaxhimin e burimeve ujore në basenet përkatëse, duke u përqendruar në miratimin e lejeve/autorizimeve dhe planet e menaxhimit të baseneve lumore.

8. Zyrat e Administrimit të Baseneve Ujore (ZABU) janë degë/drejtori rajonale të AMBU-së përgjegjëse për hartimin e inventarëve të burimeve ujore në sasi dhe cilësi, menaxhimin e

aplikimeve për lejet/autorizimet ujore, monitorimin e përdorimit të ujit, prodhimin e raporteve periodike për KBU-në.

9. Prefektët kanë rol kryesor në nivel lokal për planifikimin e emergjencave civile dhe menaxhimin e krizave brenda kufirit të tyre administrativ.

10. Drejtoritë rajonale të ujitjes dhe kullimit (Lezhë, Fier, Durrës, Korçë) janë përgjegjëse për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes dhe kullimit dhe të të gjitha veprimeve/masave të mbrojtjes nga përmbytja në zonën e tyre të funksionimit, me qëllim eliminimin e ujit të tepërt, parandalimin e akumulimit të ujit dhe përmbytjeve.

11. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) është përgjegjës për administrimin e gjeoinformacionit dhe për bashkërendimin e punës ndërmjet palëve të ndryshme të interesit që kanë përgjegjësi në lidhje me mbledhjen, gjenerimin, përpunimin dhe përditësimin e gjeoinformacionit, duke përfshirë temat që kanë lidhje me burimet ujore, siç janë hidrografia dhe hidrologjia, për të siguruar që gjeoinformacioni të jetë i plotë, i saktë, i përditësuar dhe lehtësisht i arritshëm për të gjitha palët e interesuara.

Sektori i ujit, institucionet e ngritura dhe përgjegjësitë, nga Strategjia Kombëtare e Ujit, 2019:

Sektori i ujit është i organizuar si një sistem me dy nivele, ku qeveria kombëtare është përgjegjëse për strategjitë e sektorit dhe zhvillimin e politikave, dhe qeveritë lokale për ofrimin e shërbimeve. Qeveria qendrore ka rolin kryesor në kanalizimin e fondeve të donatorëve dhe thesarit për përmirësim të kapitalit, bazuar në vlerësimin e nevojave nëpërmjet masterplaneve Kombëtare dhe shprehjeve të nevojave nga qeveritë lokale. Ajo, gjithashtu, siguron garanci sovrane për huat nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe subvencione për ndërmarrjet e ujit për të mbuluar kostot e tyre të energjisë elektrike. Qeveria e Shqipërisë gjithashtu ka hartuar një Strategji afatgjatë Financimi për Sektorin e Ujësjellësit dhe Kanalizimeve në Shqipëri, e cila përfshin përcaktimin e objektivave dhe synimeve të politikave kombëtare të sektorit.



Figura 1. Aktorët kryesorë institucionalë
Burimi: Strategjia Kombëtare e Ujit, mars 2019

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është Ministria e linjës përgjegjëse për sektorin e ujit në Shqipëri. MIE është përgjegjëse për caktimin e prioriteteve kryesore të sektorit të ujit si Zhvillimi dhe zbatimi i reformës në sektorin e ujit; Sigurimi i asistencës teknike në mbështetje të ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve në kontekstin e ndryshimeve si rezultat i reformës territoriale, certifikimi i stafit drejtues operacional (për stafin drejtues deri në nivelin e mesëm drejtues) etj.

Agjencia Kombëtare për Ujësjellës-Kanalizimet dhe Infrastrukturën e Mbetjeve (AKUM)[1] është një njësi ligjore, individuale dhe buxhetore nën varësinë e MIE-së. Kjo Agjenci Kombëtare përfaqëson të vetmin institucion teknik të specializuar të qeverisë në sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë e saj kryesore përfshijnë analizën, identifikimin dhe hartimin e politikave, strategjive dhe planeve të menaxhimit të furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe mbetjeve të ngurta.

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

ERRU-ja është një institucion i pavarur publik që rregullon sektorin e ujësjellësit dhe kanalizimeve për të siguruar mbrojtjen e interesit publik dhe krijimin e një kuadri rregullator transparent. Funksionet kryesore të ERRU-së në vijim paraqesin funksionet kryesore të ERRU-së:

- licencimi i të gjithë personave fizikë dhe juridikë që ofrojnë shërbim ujësjellës-kanalizime për përfitim publik;
- të sigurojë që operatorët t'ju ofrojnë konsumatorëve shërbime me cilësi të mirë dhe efikase dhe me çmim të arsyeshëm;
- të përcaktojë tarifat e shërbimit, në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmëri financiare të operatorëve të shërbimit, si dhe përballimin e tyre nga klientët.

Këshilli Kombëtar i Ujit është një autoritet qendror vendimmarrës në fushën e administrimit të burimeve ujore në Republikën e Shqipërisë. Këshilli Kombëtar i Ujit (NWC) është organi kryesor ndërinstitucional i kryesuar nga Kryeministri i Shqipërisë, zëvendëskryeministri dhe ministrat e linjës përgjegjës për hartimin e politikave dhe planeve për menaxhimin e integruar të burimeve ujore.

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore[2]është autoriteti ekzekutiv i KKU-së i krijuar kohët e fundit në Kryeministri, përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe strategjive në lidhje me burimet e integruara ujore në Shqipëri, duke garantuar funksionimin dhe monitorimin efektiv të sistemit të plotë të integruar të ujit në vend. Agjencia luan gjithashtu rolin e Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit.

Këshillat e Baseneve Ujore janë krijuar me VKM-në nr. 342, datë 4.5.2016, "Për miratimin e kufijve territorialë e hidrografikë të baseneve ujore në Republikën e Shqipërisë dhe qendrën e përbërjen e këshillit të secilit prej tyre", ndërsa zyrat e menaxhimit të baseneve të lumenjve (4) [3] janë krijuar sipas Agjencisë Kombëtare të Menaxhimit të Burimeve Ujore. Kryetari i KBU-së është prefekti i prefekturës më të madhe të qarkut në të cilin ndodhet baseni ujor, nënkryetari i KBU-së zgjidhet nga Këshilli i Basenit Ujor. Sekretari i KBU-së është drejtuesi i Agjencisë së Basenit Ujor. Shqipëria, në funksion të administrimit të burimeve ujore, është e ndarë në gjashtë basene ujore, si më poshtë: baseni ujor Drin–Bunë; baseni ujor Mat; baseni ujor Ishëm–Erzen; baseni ujor Shkumbin; baseni ujor Seman dhe baseni ujor Vjosë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Financave, bazuar në prioritetet e qeverisë, është përgjegjëse për shpërndarjen e burimeve financiare për sektorin e ujit për plotësimin e nevojave të shoqërisë. Ministri i Financave është anëtar i Këshillit Kombëtar të Ujit.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) ka përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha aspektet mjedisore të Direktivës kryesore të Ujit dhe direktivave të tjera të BE-së të transpozohen, koordinohen dhe zbatohen në Shqipëri. Dy institucione të kësaj ministrie, siç janë Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve kanë rol të rëndësishëm në çështjet e ujit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është përgjegjëse për të hartuar dhe zbatuar

---

[1] VKM nr. 431, datë 11.7.2018, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve".

[2] VKM nr. 221, datë 26.4.2018, "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore".

[3] Urdhri i Kryeministrit nr. 1.10.2018, "Për miratimin e strukturës së Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore".

politika dhe strategji në sektorin e kujdesit shëndetësor. Bazuar në kuadrin aktual ligjor në fuqi, Ministria është përgjegjëse për inspektimin dhe monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm përmes institucioneve të saj si strukturat rajonale të shëndetit publik, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Njësitë e qeverisjes vendore

Qeveria shqiptare zhvilloi dhe zbatoi me sukses reformën administrative territoriale (RAT), duke riorganizuar qeverisjen lokale në 61 bashki. RAT-i ka krijuar njësi më të mëdha të qeverive vendore, të cilat administrojnë një territor më të madh, të riorganizuar dhe të konsoliduar.

Qeveritë vendore, si pronarë të ndërmarrjeve ekzistuese të ujësjellësit dhe kanalizimeve brenda kufijve të tyre administrativë, si dhe të gjitha aseteve të infrastrukturës së ujësjellësve dhe kanalizimeve në komunat e mëparshme që janë bashkuar në NJQV të përcaktuara së fundmi, aktualisht kanë sfidën për të ofruar shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në territoret e tyre të zgjeruara pas miratimit të reformës administrative territoriale (RAT). Në vitin 2016, bashkive iu kërkua të ristrukturojnë veprimet e tyre të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në përgjigje të realiteteve të reja të RAT-it dhe kërkesës në rritje për shërbime.

1.5 Përmirësimet e kapaciteteve në zbatimin e kritereve të BE-së në lidhje me ujërat dhe planifikimin e infrastrukturës

Zbatimi i kritereve të DTUNU-së dhe DUP-it kërkon administrim me kapacitete dhe aftësi të mëdha në nivel kombëtar dhe vendor. Në radhë të parë, administrata kombëtare do të duhet të krijojë kushte të nevojshme për zbatimin e direktivave. Më pas, ajo do të duhet të udhëzojë qeveritë vendore për të përmbushur detyrimet e tyre. Planifikimi dhe kontrolli kryesor i investimeve të financimit strategjik kontrollohet në nivelin kombëtar, por përgjegjësia kryesore për ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe të grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura u takon bashkive.

Gjatë viteve të ardhshme, bashkitë do të duhet të trajtojnë një numër detyrash të rëndësishme: planifikimin e infrastrukturës ujore, identifikimin e projekteve të mundshme, hartimin e dokumentacionit teknik, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve të investimeve. Kjo kërkon njohuri, aftësi dhe përvojë të gjerë, të cilat aktualisht nuk janë lehtësisht të disponueshme në të gjitha bashkitë.

Procesi i zhvillimit të PZDS-ve dhe programit të investimeve do të qartësojë numrin dhe gamën e masave (infrastruktura "e rëndë" dhe reformat "e buta") që nevojiten. Nga këto mund të përcaktohen kriteret e kapaciteteve dhe aftësive të partnerëve institucionalë të projektit dhe të krijohet një plan zhvillimi. Procedurat që përcaktojnë marrëdhëniet midis përgjegjësisë dhe burimeve të qeverisë kombëtare dhe kritereve dhe kapaciteteve të qeverisë vendore do të jenë thelbësore për funksionimin e sistemit.

1.6 Ndihma teknike e vazhdueshme:

Uji është një sektor me përparësi të lartë për Shqipërinë. Një gamë e larmishme e përdoruesve të ujit, nga uji i pijshëm në turizëm dhe mungesa e një zhvillimi thelbësor të menaxhimit të burimeve ujore ka rezultuar në një listë të plotë të nevojave për ndryshime. Institucionet shqiptare dhe partnerët e tyre ndërkombëtarë po rritin aktivitetet e tyre, por ende mbetet shumë për të bërë.

Në zhvillimin e politikave të ujit, asistenca teknike e financuar nga BE-ja po mbështet menaxhimin e integruar të ujit nëpërmjet Agjencisë Austriake për Zhvillim, shërbimeve të ujërave të ndotura përmes GIZ-it dhe investimeve të projekteve nëpërmjet KfW-së. Suedia po mbështet krijimin e AMBU-së dhe mbështetjes së negociatave të BE-së (SANE 27).

Ndërsa është thelbësor koordinimi i ngushtë i këtyre përpjekje ndërkombëtare për mbështetje, planifikimi në përputhje me BE-në për ujin e pijshëm dhe ujërat e ndotura nuk po mbështetet nga ndonjë asistencë tjetër teknike. Kjo do të jetë gjithashtu asistenca e vetme sektoriale e ujit për t'u përgatitur për negociatat (në bashkëpunim me SANE27) dhe për planifikimin e llumit.

2. Objektivi i përgjithshëm:

Të zhvillohen aftësitë e planifikimit strategjik në sektorin e ujërave për zbatimin e standardeve të BE-së.

Rezultati 1. Raport i përgatitur për grupimet e identifikuara për zonat e ujërave të ndotura dhe furnizimit me ujë dhe zonat sensitive

Do të përgatitet një analizë, konsultim dhe propozim për grupimet, zonat sensitive dhe zonat e furnizimit me ujë në përputhje me DTUNU-në, DUP-in dhe kur është e nevojshme, me kriteret e DKU-së. Ky informacion do të sigurojë bazën për zhvillimin e mëtejshëm të dokumenteve të planifikimit.

Rezultati 2: Plane të zhvilluara të zbatimit të direktivës specifike për DTUNU-në dhe DUP-in

Planet e zbatimit të direktivës specifike (PZDS) do të përbëhen nga të gjitha masat që kërkohen për të garantuar përputhshmërinë me DTUNU-në dhe DUP-in në kontekstin e DKU-së. Ato do të paraqesin hendekun midis standardeve të nevojshme dhe situatës ekzistuese, do të përcaktojnë pjesën e rëndë (infrastrukturën) dhe të butë (asistencën teknike) për të mbyllur hendekun, do të propozojnë një qasje zbatimi të përballueshme dhe të arritshme, programin për investime dhe do të përfundojë me një vlerësim të periudhës së tranzicionit për të cilën Shqipëria do të duhet të aplikojë gjatë negociatave të pranimit.

PZDS-të synojnë të përmbushin qëllimet e mëposhtme:

- Mbështetje për planifikimin për zbatimin e *acquis* të investimeve të mëdha. PZDS-të do të përcaktojnë standardet që duhet të arrihen në planin afatgjatë dhe kështu të sigurojnë një pikë referimi të qëndrueshme për planifikim. Një kuptim i qartë i nevojave dhe i kohës së investimeve mund të zvogëlojë koston e përgjithshme të përmbushjes së standardeve të nevojshme.
- Arsyetim i aplikimeve për financim. Është deklaruar qëllimi i i shumë donatorëve/IFN për të mbështetur dëshirën e Shqipërisë për t'u anëtarësuar në BE. Investimet e përcaktuara dhe me përparësi brenda PZDS-ve për të cilat është rënë dakord me pak besim mund të mbështeten. Arsyetimi i qartë i investimeve mund të tërheqë fonde shtesë.
- Për të mbështetur procesin e negociatave të kapitullit 27 të pranimit në BE. Përvoja e vendeve kandidate të BE-së dhe vendeve të reja anëtare tregon se planifikimi afatgjatë, realist është thelbësor për të siguruar një pozicion të besueshëm negociatash.

Rezultati 3: Strategjia e zhvilluar e menaxhimit të llumit

Llumi nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura urbane është faktor kryesor për planifikimin e investimeve dhe përballueshmërinë e infrastrukturës së re[4]. Synimi është që ky planifikim investimi të çojë në një rritje të numrit të projekteve të ujërave të ndotura, të cilat shumë shpejt do të fillojnë të gjenerojnë sasi të mëdha të llumrave. Problemet dhe kostot shtesë kanë qenë shumë të mëdha kur menaxhimi i llumit është anashkaluar ose shtyrë në vendet e BE-së.

Strategjia e Menaxhimit të Llumit, e hartuar në bazë të këtij projekti, do të sigurojë një drejtim strategjik dhe plan veprimi për integrimin e planifikimit të menaxhimit të llumrave në procesin e zhvillimit të ujërave të ndotura. Strategjia do të përcaktojë kriteret teknike, financiare, ligjore dhe administrative për të mundësuar zbatimin praktik të qasjes së re.

Ka përfitime të konsiderueshme nga integrimi i strategjisë së PZDS-së, DTUNU-së dhe të Llumit brenda të njëjtit projekt si teknikisht (për herë të parë PZDS-së do t'i mundësojë Shqipërisë të dijë sasinë e llumit të gjeneruar, cilësinë e tij dhe periudhat në të cilat do të gjenerohet), ekonomikisht (planifikimi i impianteve të trajtimit të llumit në të njëjtën kohë me impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura duhet të kursejnë kostot operative dhe kapitale afatmesme dhe afatgjata) dhe financiarisht (kostoja e asistencës teknike do të jetë më e lirë sesa po të bëhet veçmas).

Rezultati 4: Programi i zhvilluar për furnizimin me ujë dhe mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura 2021–2027 dhe 2028–2034

PZDS-të e përgatitura në bazë të këtij projekti do të gjenerojnë një listë të plotë të masave të nevojshme që Shqipëria të jetë në pajtim me direktivat përkatëse.

Nga kjo listë e plotë do të përgatitet një listë e përzgjedhur për të identifikuar programin e parë të projekteve, 2021–2027, në përputhje me periudhat e planifikimit financiar shumëvjeçar të BE-së. Ky

[4] Kostot e menaxhimit të llumit mund të jenë deri në 50% e të tërë kostove të operimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të ujërave të ndotura.

program do të zhvillohet në detaje për të mundësuar planifikimin financiar. Gjithashtu, do të përgatitet një program i dytë 2028–2034 me më pak detaje, por i mjaftueshëm për të përcaktuar asistencën teknike për përgatitjen e projektit të kërkuar në periudhën e parë.

Programi do të mbështetet nga procedurat për vendosjen e prioriteteve dhe përditësimin e listës së shkurtër për të siguruar që të mbetet realist dhe koherent në kontekstin e PZDS-së më të gjerë. Bazuar në përvojën e mëparshme të pranimit në BE, mund të pritet që periudha më e gjatë e tranzicionit (dhe kështu më e përballueshme) që Shqipëria të mund të negocionte për nenet më sfiduese të DTUNU-së, do të ishte afërsisht 2042.

Rezultati 5: Legjislacioni i hartuar për të mundësuar përfundimin e transpozimit të Direktivës së Ujit të Pijshëm (DUP) dhe Direktivës së Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane (DTUNU)

Qasja e bazuar te pajtueshmëria dhe dokumentet e planifikimit të hartuara përmes këtij projekti do të kërkojnë hartimin e legjislacionit të ri (ligje ose akte nën ligjore) dhe ndryshime në dokumentet ligjore ekzistuese kombëtare. Për shembull, identifikimi i zonave sensitive dhe grupimeve në legjislacionin kombëtar.

Ky projekt do të identifikojë se çfarë mbetet për t'u transpozuar në fushat e DUP-së dhe DTUNU-së dhe do të hartojë dokumente të reja sipas nevojës.

Rezultati 6: Një plan zhvillimi kapacitetesh për të mbështetur zbatimin e PZDS-ve

Përmbushja e standardeve të përcaktuara në objektivat strategjikë të Shqipërisë dhe BE-së do të kërkojë një rritje të madhe të kapaciteteve (sasia e projekteve) dhe aftësive (gama e aftësive të ndryshme teknike) të institucioneve administrative shqiptare. Sektori i ujit kërkon sasinë më të madhe të investimeve publike brenda kapitullit 27 të BE-së, kapitulli më i madh i *aquis* të ligjit të BE-së.

Plani i Zhvillimit të Kapaciteteve do të vlerësojë nevojat për zbatim kundrejt strukturës institucionale ekzistuese, do të propozojë masa zhvillimi dhe do të ofrojë module të trajnimeve fikse, mentorimit në vend të punës, mjete dhe modele. Puna zhvillimore do të përqendrohet në institucionin kryesor partner, MIE, por, gjithashtu, do të ofrojë mbështetje edhe për institucione të tjera kombëtare dhe vendore të përfshira drejtpërdrejt në ofrimin e standardeve të përmirësuara të menaxhimit të ujit.

Aftësitë, njohuritë dhe ekspertizat e mundshme të nevojshme për MIE-n dhe AKUM-in për zbatimin e periudhës së parë të investimeve, do të përcaktohen nga rolet institucionale përkatëse. Për shembull:

<u>Ministria:</u> me përfundimin e dokumenteve kryesore strategjike në këta nënsektorë (ujësjellësi dhe kanalizimet), roli i ministrisë do të përqendrohet në shndërrimin e strategjive në programe realiste, të besueshme, në kontrollin e cilësisë, rishikimin e strategjisë dhe raportimin. Mbështetjet/trajnimet tipike të zhvillimit mund të përfshijnë:

- mentorim të niveleve të larta për pranimin në BE;
- financim të programeve mjedisore;
- menaxhim të ciklit të programeve;
- monitorim dhe vlerësim të metodologjive dhe sistemeve;
- raportim.

<u>AKUM-i:</u> në rolin e tij si agjenci zbatuese, AKUM-i do të duhet të zhvillojë aftësinë për të mbështetur procesin e programimit të ministrisë dhe më pas të kryejë prokurimin, kontraktimin dhe zbatimin e projekteve me standardet e BE-së, bazuar në financimin e kombinuar nga i cili pjesa më e madhe do të jenë nga fondet IPA të BE-së. Është e kuptueshme që aftësitë e ardhshme të menaxhimit të projekteve do të mund të mbështeten te qasjet ekzistuese, por gjithashtu të zgjerohen për të përfshirë një gamë më të gjerë burimesh financimi. Trajnimet tipike mund të përfshijnë:

- studimet e fizibilitetit të BE-së;
- zhvillimin e analizës kosto përfitime të BE-së;
- qasjet e kontrollit të cilësisë për përgatitjen e projekteve;
- sistemet e menaxhimit të decentralizuar të BE-së (SMD të BE-së);

- trajnim dhe certifikim për menaxhimin e projekteve.
- Sistemet e menaxhimit mjedisor për projektet.

Autoritetet vendore: trajnimi dhe certifikimi për autoritetet vendore do të përcaktohen në bazë të ligjit të ri (prezantimi i një Bordi Certifikimi). Mbështetja e zhvillimit sipas këtij projekti do të kërkojë të mbështesë një sistem të tillë të kontrollit të cilësisë. Trajnimet mund të përfshijnë:

- planifikimin e sistemeve moderne të menaxhimit të ujërave;
- trajnim mbi menaxhimin e projekteve;
- hartimin e dokumentacionit teknik;
- operimin dhe mirëmbajtjen e aseteve të ujërave.

Supozimet, risqet dhe analiza e zbutjes

Supozimet mbi të cilat është bazuar ky projekt janë si më poshtë:

- Të dhënat: shoqëritë publike të ujësjellësit, qeveria qendrore dhe projektet përkatëse që janë në vazhdim janë të gatshme për të bashkëpunuar dhe shkëmbyer të gjitha informacionet teknike, administrative dhe institucionale të disponueshme në lidhje me infrastrukturën e ujit të pijshëm dhe kanalizimeve;

- Partnerët: partnerët kryesorë i kushtojnë kohë të mjaftueshme stafit, në të gjitha nivelet, për të marrë pjesë dhe për të përfituar nga projekti;

- Pjesëmarrja: aktorët më të gjerë, siç janë bashkitë, projektet e asistencës teknike, organet profesionale, sfera akademike, përfaqësuesit e industrisë dhe organizatat e shoqërisë civile do të marrin pjesë dhe do të angazhohen në mënyrë konstruktive për këto çështje, me kusht që komunikimi të organizohet si duhet;

- Vendimmarrja: zhvillimi i politikave do të kërkojë vendimmarrje nga institucionet kombëtare. Ky planifikim supozon që vendimet në nivel projekti mund të merren në kohën e duhur për të mundësuar vazhdimin e zbatimit të tij.

Risku	Mundësitë	Ndikimi	Totali	Masat zbutëse
Të dhënat nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar planet	2	5	10	Koordinimi në procesin e planifikimit para projektit ka krijuar të dhëna të rëndësishme që janë mbajtur nga institucione të tilla si AKUM. Koha dhe burimet janë përfshirë për të studiuar grupimet dhe zonat sensitive si një aktivitet i veçantë.
Mungesa e vendimmarrjes për shkak të përgjegjësive të paqarta ose të ndryshimit të tyre	4	3	12	Kjo është një çështje e njohur, por MIE ka një mandat të qartë për politikën e ujit. Planifikimi i investimeve do të jetë më i vështirë. Është thelbësor angazhimi me institucionet e tjera që nga fillimi.
Ndryshimi politik në nivel kombëtar ose institucional	4	2	8	Ristrukturimi i qeverisë është pjesë normale e projekteve të zhvillimit. Uji mund të mbetet prioritet i lartë për çdo qeveri edhe nëse nuk do të jetë pranimi në BE. Ndryshimet politike janë jashtë kontrollit të projektit, por periudha e zbatimit 27-mujor duhet të ofrojë kohë të mjaftueshme për të kapërcyer vonesat e përkohshme.
Humbja e partnerëve kyç institucionalë*	4	3	12	Një numër i vogël i personelit kyç mund të sjellë një ndryshim të madh në këtë kohë të rëndësishëm për zhvillimin e politikave. Ndryshimi i personelit nuk mund të parandalohet, por dokumentacioni i qartë i projektit, procedurat dhe mjetet dhe modelet për ndërtimin e kapaciteteve mund të zvogëlojnë ndikimin e ndryshimeve individuale.
Risku financiar	3	3	9	Donacioni është në SEK, monedha e punës në Shqipëri është normalisht euro ose lekë. Kjo është një periudhë e luhatjeve të mëdha të monedhës. Në kontratën kryesore të shërbimit do të përfshihen metodat për të menaxhuar ndryshimet e konsiderueshme në monedhë.

Tabela 1. Matrica e riskut. Pikët: 1 (e ulët) – 5 (e lartë)

Qarkullimi i stafit. Procesi i pranimit në BE është i gjatë dhe periudha e përafrimit (koha e kërkuar për të përmbushur standardet) është edhe më e gjatë. Qarkullimi i stafit gjatë kësaj periudhe është i pashmangshëm dhe në një farë mase institucionet e BE-së mbështeten në

tërheqjen e një pjesë të stafit më të mirë kombëtar nga shtetet e reja anëtare që "ana e Brukselit" të funksionojë. Me një ritëm në rritje, forcat e tregut nga sektori privat do të ofrojnë alternativa për stafin me përvojë të sektorit publik, veçanërisht ata që kuptojnë planifikimin kryesor të investimeve në sektorin e ujit. Në të njëjtën kohë, nëpunësit civilë kanë më shumë gjasa të vlerësojnë shërbimin publik dhe në këmbim dëshirojnë të eksplorojnë mundësitë për zhvillim të karrierës.

MNPI-ja e ujit do të jetë sensitiv ndaj humbjes së partnerëve kryesorë në të njëjtën mënyrë si projektet e tjera dhe ndaj duhet të planifikojë për këtë aspekt. Masat zbutëse që mund të ndërmarrë projekti janë:

- Të ofrojë mundësi për partnerët që të ndërtojnë përvojë unike, përcaktuese për karrierën. Shqipëria do të ketë (me shumë gjasë!) vetëm një negocim me BE-në dhe Uji është ndoshta nënsektori më i madh i vetëm në të gjithë kapitujt. Puna e bërë nga MIE/AKUM-i me mbështetjen e Suedisë dhe këtij projekti duhet t'ia vlejë që të angazhohen për të. Për të krijuar një ekip të përkushtuar, kjo mundësi duhet të komunikohet dhe kuptohet, veçanërisht nga drejtuesit e ministrisë. MNPI e ujit duhet të ketë përfshirje aktive të drejtuesve të lartë që në fillim.

- Të planifikojë dhe ofrojë procedura të qarta për zhvillimin, konsultimin dhe vendimmarrjen. Me burime të kufizuara dhe presion të konsiderueshëm me të cilin përballen shumica e institucioneve të sektorit publik, është e rëndësishme që kjo detyrë e shtuar (aderimi në BE nuk konsiderohet si biznes i zakonshëm) të bëhet sa më e menaxhueshme të jetë e mundur. Një plan i qartë për atë që kërkohet nga njësitë e ndryshme dhe për kohën kur duhet të merren vendimet, do ta zvogëlojë presionin. Ky do të jetë një detyrim i konsulentit të projektit gjatë fazës së fillimit.

- Procedurat e përcaktuara dhe dokumentet mbështetëse gjithashtu do të ndihmojnë në zbutjen e ndikimit nga ndryshimi i stafit. Trajnimi i stafit të ri dhe transferimi i përgjegjësive bëhet më efektiv nëse procesi është përcaktuar qartë, nëse përcaktohen modele dhe lista kontrolli.

- Të ofrojë mbështetje teknike. Aktorëve kryesorë do t'u kërkohet të rishikojnë, komentojnë dhe përfundimisht të pranojnë dokumente kryesore, komplekse (PZDS) me ndikim afatgjatë. Këto dokumente ose gjetjet e tyre kryesore do të shqyrtohen nga publiku dhe vendet e tjera. Mbështetja teknike për drejtuesit me përvojë të Autoritetit Kontraktues në formën e një monitorimi dhe mbështetje këshilluese do t'i ndihmonte drejtuesit kombëtare.

4. Kontributet teknike

- Zhvillimi i projektit: Ndihmë teknike për të përgatitur projektin për financim dhe mbështetje për prokurimin e kontratës kryesore të shërbimit, e prokuruar nëpërmjet Ambasadës së Suedisë në Shqipëri.

- Kontrata kryesore e shërbimit: asistencë teknike për të zhvilluar rezultatet e shprehura në fushat e ujit, pranimit në BE dhe planifikimit strategjik do të kontraktohet nëpërmjet MIE-së.

- Mbështetje për zbatimin: asistencë teknike për zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e cilësisë.

5. Menaxhimi dhe komunikimi me grupet e interesit:

Partneri kryesor: MIE

Partnerët dytësorë:

- AKUM-i, si partner kyç, si nga pikëpamja e prokurimit, edhe nga pikëpamja e një përdoruesi kryesor të dokumenteve të prodhuara nga ky projekt.

- Institucionet publike dhe programet e tyre të asistencës teknike të përfshira në zhvillimin e politikës kombëtare, legjislacionit, ofrimit të shërbimeve të ujit dhe entet rregullator.

- Grupe të tjera të interesuara, duke përfshirë sferën akademike, organizatat e shoqërisë civile dhe sektorin tregtar.

- Donatorët ndërkombëtarë dhe organizatat financuese.

Partnerët tretësorë: publiku i gjerë.

Do të zhvillohet një qasje komunikimi që nga fillimi për të siguruar që interesat e të gjitha palëve të interesuara dhe me ndikim të merren në konsideratë gjatë hartimit të këtyre dokumenteve kryesore. Analiza e palëve të interesuara do të integrojë qasjen e Sida-s të bazuar në

të drejtat e njeriut, për të siguruar identifikimin dhe përfshirjen e popullsisë vulnerabil brenda grupeve të palëve të interesuara. Një grafik i publikuar i konsultimeve do të përcaktojë në mënyrë transparente qëllimet e dokumentacionit të planifikimit dhe do të përshkruajë mënyrën dhe kohën kur do të diskutohen dokumentet. Kostot dhe koha për komunikimet efektive do të përfshihen në buxhetin e projektit.

Komunikimi me autoritetet vendore: autoritetet vendore janë përgjegjëse sipas ligjit për ofrimin e shërbimeve vendore të ujit. Administratat vendore, përmes 58 shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, zotërojnë dhe administrojnë sistemet e furnizimit me ujë dhe ujërave të ndotura. Procesi i pranimit dhe përafrimit në BE është, për nga natyra strategjike, një proces kombëtar. Shqipëria duhet të përcaktojë objektivat për përmbushjen e standardeve të BE-së dhe do të alokojë pjesën më të madhe të burimeve financiare dhe teknike që i janë dhënë vendit në formë donacioni (ose që janë marrë hua).

Si rrjedhojë, zhvillimi i pozicionit negociues dhe planeve specifike në lidhje me direktivën është një proces që kërkon konsultime të gjera si vertikalisht midis nivelit kombëtar dhe atij vendor, edhe horizontalisht për të përfshirë aktorët e tjerë të interesuar si sferën akademike, shoqërinë civile, biznesin dhe partnerët ndërkombëtarë.

Gjatë periudhës së fillimit, konsulenti do të kryejë analizën e palëve të interesuara, do të zhvillojë qasjen e komunikimit, një grafik dhe burimet për komunikimet dhe elementet e nevojshme. Angazhimi me bashkitë dhe ndërmarrjet e ujësjellësit shpesh mundësohet nëpërmjet shoqatave të qeverisjes vendore. Është alokuar një buxhet brenda linjës së buxhetit "Të rimbursueshme" për konsultime të shumëfishta gjatë periudhës së fillimit dhe më pas nën secilin prej rezultateve të projekteve.

Komunikimi me AMBU-n: MIE-ja dhe AMBU-ja kanë një konsultim të përcaktuar dhe të rregullt në kuadër të Komitetit Drejtues të Projektit IPA 2016 për ujin si burim. Këto konsultime zhvillohen një herë në 6 muaj. Koordinimi midis institucioneve drejtuese do të përdorë dhe zgjerojë këtë strukturë ekzistuese si të nevojshme, më mirë sesa të krijojë forume të reja me të njëjtët persona.

Në nivel teknik do të ketë diskutime më të hollësishme mbi integrimin e çështjeve të direktivës kuadër të ujit midis ekipeve teknike. Konsultimet do të zhvilloheshin të paktën çdo 6 muaj si pjesë e raportit të ndërmjetëm dhe përgatitjes së planit të punës.

6. Prokurimi

Prokurimi për kontratën kryesore të shërbimit, bazuar në tarifa, do të kryhet në bazë të ligjit shqiptar për prokurimet duke përdorur procedurat PRAG të BE-së të përshtatura për AKUM-in si autoritet kontraktues dhe menaxhues i Njësisë së Zbatimit të Projektit (NJZP) brenda AKUM-it. Vlerësimi do të kryhet nga një komision i veçantë vlerësues i krijuar nga drejtori i përgjithshëm i AKUM-it.

Procedura për lidhjen e kontratës kryesore të shërbimit pritet të jetë prokurim i kufizuar, me një fazë të vetme dhe i hapur ndërkombëtar (dy zarfe) me parakualifikim, siç përcaktohet në PRAG.

Qasja e prokurimit do të përcaktohet në një Plan Prokurimi për të cilin do të bihet dakord paraprakisht nga Bordi i Projektit. Bordit, gjithashtu, do t'i kërkohet një "Moskundërshtim" për pikat e mëposhtme:

- dosja e tenderit;
- raporti i parakualifikimit;
- raporti i vlerësimit përfundimtar.

7. Menaxhimi i Projektit

Drejtimi i Projektit: Bordi i Projektit do të krijohet më parë nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë. Ai do të drejtohet nga MIE (e përbërë nga MIE, Suedia, AKUM-i). Bordi do të takohet të paktën çdo 6 muaj dhe do të marrë vendime kryesore, si pranimi i rezultateve dhe autorizimi i planeve të punës.

Njësia për Zbatimin e Projektit e udhëhequr nga AKUM-i (e përbërë nga AKUM-i, konsulent

i projektit dhe të tjerë siç kërkohet). NJZP-ja do të takohet të paktën çdo muaj, do të përgatisë vendime për Bordin dhe do të menaxhojë punën e përditshme të projektit.

Konsulenti i projektit do t'i ofrojë mbështetje sekretarit të NJZP-t për të menaxhuar administratën. Pjesëmarrës shtesë mund të përfshihen në secilin forum me marrëveshjen e anëtarëve kryesorë.

Struktura e Projektit



Figura 2. Organigrama e AKUM-it (institucion i ri i krijuar, 2019)

AKUM-i është ristrukturuar dhe është në proces të përcaktimit të procedurave të reja. Struktura e re do të ketë 50 të punësuar. Stafi ekzistues mbetet (një staf prej 30 personash relativisht me përvojë) plus stafi i ri që do të jetë më i ri (brezi i ri). AKUM-i aktualisht po udhëheq projektin e madh të ujit nga BE-ja me 4–5 specialistë të përhershëm.

Stafi kryesor në AKUM në lidhje me këtë projekt, në Njësinë për Zbatimin e Projekteve Ndërkombëtare (koordinimin e projektit) dhe Drejtorinë e Ekonomisë dhe Shërbimeve Mbështetëse (prokurimi) janë trajnuar në PRAG. Nuk është kryer një inspektim i sistemit për kapacitetin e prokurimit të AKUM-it dhe do të bëhet për herë të parë pjesë e këtij Projekti me mbështetjen suedeze.

AKUM-i do të duhet të sigurojë koordinim, administrim dhe menaxhim financiar për kontratën. Përgjegjësitë e agjencisë do të përfshijnë, por nuk do të kufizohen vetëm te:

- koordinimi në mbështetje të MIE-s. AKUM-i do të sigurojë menaxhimin e përditshëm të proceseve të projektit, nga prokurimi deri tek mbyllja. Koordinatori do të ofrojë drejtim të qartë për konsulentin për të gjitha çështjet të cilat nuk është e nevojshme të kalojnë te bordi i Projektit;
- prokurimi është planifikuar, dosja e tenderit dhe dokumentet e kontratës janë zhvilluar, prokurimi është shpallur, procesi i listës së përzgjedhur është i plotë, ofertat teknike janë kërkuar, marrë dhe vlerësuar, vendimet janë marrë, çdo proces i apelimit është menaxhuar dhe bëhet kontraktimi;
- menaxhimi i kontratës do të kërkojë që raportet të rishikohen (potencialisht me ndihmë nga mbështetja teknike), të koordinohen me palët e interesuara institucionale dhe vendimet të regjistrohen;
- menaxhimi financiar duke përfshirë që disbursimet të llogariten dhe kërkohen, të bëhen pagesat, të mbahen evidencat dhe të menaxhohen auditimet.

AKUM-i do të identifikojë një koordinator të lartë, një zyrtar të projektit dhe një zyrtar financiar

për këtë projekt. Nuk pritet që këto të jenë role me kohë të plotë. Projekti do të sigurojë mbështetje financiare për AKUM-in, në mënyrë që të rritet aftësia e institucionit për të menaxhuar dhe administruar projektin MNPI të ujit. Fondi do të mbështesë rekrutimin e stafit të ri dhe për këtë arsye, do të kontribuojë në kapacitetin e përgjithshëm të AKUM-it, duke mundësuar që anëtarët më me përvojë të stafit të punojnë në projekt.

Monitorimi i projektit dhe mbështetja këshilluese: MNPI i ujit është një projekt kompleks që përshin shumë sektorë. Kombinimi i çështjeve të pranimit në BE, çështjeve teknike të ujit, planifikimit financiar dhe ngritjes së kapaciteteve e bëjnë mjaft sfidues monitorimin dhe sigurimin e cilësisë së rezultateve dhe vlerës së mirë të parave.

Është i nevojshëm monitorimi dhe mbështetja këshilluese për të garantuar zbatimin e suksesshëm të projektit. Ndihma teknike mund të mbulojë:

- rishikimin e aktiviteteve të planifikuara dhe produkteve nga rezultatet 1–6. Konsulenti i projektit do të paraqesë produktet rreth dy herë në vit gjatë periudhës së projektit. Shumica e produkteve janë në "rrugë kritike" që do të thotë që aktivitetet e mëposhtme nuk mund të fillojnë derisa të miratohen aktivitetet e mëparshme. Gama teknike e punës që do të zhvillohet varion nga furnizimi me ujë dhe specializimi për ujërat e ndotura deri te menaxhimi i llumrave, te legjislacioni deri te financimi dhe planifikimi i investimeve, deri te çështjet horizontale dhe ngritja e kapaciteteve. Monitorimi dhe mbështetja këshilluese do të ofrojnë ekspertë për të mbështetur MIE/AKUM-in për një përmbledhje të rezultateve dhe planifikim të burimeve për periudhën tjetër;
- mbështetje të përgjithshme e menaxhimit të projektit për çështje të tilla si ndryshimet e propozuara të kontratës dhe ndryshimet e termave të referencës. Pothuajse të gjitha projektet kryesore do të kenë kërkesa për ndryshime në një fazë të caktuar qoftë nga ana e Autoritetit Kontraktues ose nga Kontraktuesi. Ndryshimet mund të jenë teknike dhe/ose me vlerë të lartë financiare. Monitorimi dhe mbështetja këshilluese do të ofrojnë ndihmë për menaxhimin e kontratës dhe çështjet e termave të referencës sipas kërkesës.

Raportimi: do të kërkohet raportim periodik bazuar në objektivat e projektit, aktivitetet dhe treguesit, siç përcaktohen në kushtet e referencës. Raportimi do të harmonizohet me kushtet e pagesës në kontratë. Minimalisht do të kërkohen raportet e mëposhtme:

- raporti fillestar do të sigurojë një vlerësim të situatës në terren në fillim të projektit në lidhje me çka është parashikuar në termat e referencës. Ai do të përshkruajë veprimet e ndërmarra gjatë periudhës së fillimit, analizën e kryer dhe do të propozojë planin e punës për periudhën e parë të veprimtarisë. Duhet të justifikohet çdo ndryshim në termat e referencës. Veprimet që lidhen me çështjet horizontale gjithashtu duhet të zhvillohen dhe përshkruhen më tej;
- raportet e ndërmjetme do të kërkohen çdo gjashtë muaj dhe do të përfshijnë një përmbledhje të aktiviteteve dhe rezultateve të periudhës së mëparshme dhe një plan pune të propozuar për periudhën në vijim;
- raporti përfundimtar do të përfshijë të gjitha aktivitetet, raportet financiare dhe produktet në një raport të vetëm. Drafti i parë i raportit përfundimtar do të bëhet jo më vonë se 2 muaj para datës së mbylljes së projektit për të lejuar kohën për rishikim dhe ripunim.

8. Çështjet horizontale

Antikorrupsioni: këto çështje do të jenë të rëndësishme për dy fusha të veprimtarisë së projektit: prokurimi i kontratës kryesore të shërbimit dhe përfitimet e një programi transparent investimi:

- metoda e prokurimit për kontratën kryesore, procedurat, institucionet përgjegjëse dhe raportimi do të përcaktohen që nga fillimi me etapa përcaktuese moskundërshtimi të përfshirë në proces;
- ndikimi afatgjatë i PZDS-ve dhe programit të investimeve duhet të jetë pozitiv në drejtim të sigurimit të investimeve të ardhshme të përcaktuara qartë nga ajo çka kontribuojnë në arritjen e objektivave kombëtarë, të cilët duhet të jenë prioritetet dhe koha kur janë të nevojshme investimet. Kur drejtimi i politikave është i paqartë, ka hapësirë për të përfshirë kosto të panevojshme ose të paqëndrueshme.

Barazia gjinore: Shqipëria u bë palë shtetërore në Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEGJFDG) nëpërmjet pranimit në datën 11 maj 1994. KEGJFDG-ja përcakton, midis të drejtave të tjera, pagë të barabartë për punë të barabartë, mundësi të barabartë punësimi, barazinë pozicione dhe akses në vendimmarrje private dhe publike.

Ligji shqiptar për barazi gjinore (2008) përcakton që integrimi gjinor do të jetë qasja për të siguruar barazinë gjinore në shoqëri, duke reflektuar perspektivat e të gjitha gjinive në proceset e ligjbërjes, hartimit, planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave. Ligji, gjithashtu, mbulon diskriminimin dhe ngacmimin dhe parashikon masa të posaçme të përkohshme për të garantuar të paktën 30% përfaqësim të gjinisë së nënpërfaqësuar në pozicione dhe administrimin e vendimmarrjeve politike dhe publike. Gjithashtu, ligji për barazi gjinore e bën të detyrueshëm prodhimin e statistikave me bazë gjinore nga organet shtetërore.

Në vitin 2017, Indeksi Global i Hendekut Gjinor e renditi përgjithësisht Shqipërinë në vendin e 38-të nga 144 vende, në vendin e 70-të për pjesëmarrjen dhe mundësitë ekonomike dhe në vendin e 120 në shëndetësi. Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore është 47.5% për gratë dhe 70.4% për burrat dhe gratë vlerësohet të fitojnë 53% të asaj që fitojnë burrat. Legjislatorët, zyrtarët me përvojë dhe menaxherët përbëhen nga 22,5% gra dhe 77,5% burra. Këto shifra të përgjithshme shqiptare përkthehen gjithashtu në sektorin e ujit, ku gratë janë të nënpërfaqësuara në pozicionet vendimmarrëse në lidhje me menaxhimin e burimeve ujore.

Zbatimi i këtij projekti do të realizojë aktivitete, evidenca dhe raportim në përputhje me praktikën e mirë të integrimin gjinor.

"Integrimi gjinor është (ri)organizimi, përmirësimi, zhvillimi dhe vlerësimi i proceseve të politikave, në mënyrë që të përfshihet perspektiva e barazisë gjinore në të gjitha politikat, në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat, nga aktorët normalisht të përfshirë në politikëbërje."

(Këshilli i Evropës 1998:12)

Shembuj të praktikës së mirë[5] që mund të jenë të zbatueshëm për këtë projekt, përfshijnë:

- Kërkesa që një konsulent për barazi gjinore të marrë pjesë në procesin e planifikimit, evidentimit dhe raportimit të projektit.

- Krijimi dhe regjistrimi i një baze fillestare të çështjeve të barazisë gjinore në fillimin e aktiviteteve të projektit ("Analiza gjinore"). Për shembull, ekuilibri gjinor në institucionet kryesore partnere dhe politikat ose masat përkatëse që zbatohen.

- Promovimi aktiv i përfaqësimit të grave në procesin e konsultimit për zhvillimin e PZDS-ve dhe alokimin e posaçëm të burimeve për ta bërë këtë. Kjo ka një aspekt të rëndësishëm teknik sepse një pjesë kryesore e administrimit të kostove operative të sistemeve moderne të administrimit të ujërave të ndotura ose efikasitetit të ujit në menaxhimin e furnizimit me ujë është angazhimi dhe pjesëmarrja e qytetarëve. Në nivelin e familjeve mund të supozohet se gratë do të kenë ndikim më të madh në ndryshimin e sjelljes ("Integrimi i barazisë gjinore"). Aspekti i vizibilitetit të kësaj qasje do të jetë i rëndësishëm për të filluar procesin e komunikimit që qytetarët të kenë një rol në mbajtjen e kostove të ulura për shërbimet publike në të ardhmen.

- Promovimi dhe evidentimi i pjesëmarrjes në aktivitetet e projektit që lidhen me ngritjen e kapaciteteve.

Çështjet e mjedisit: ndërsa ky projekt bazohet në sigurimin e performancës më të mirë të mjedisit, mënyra sesi ndodh zbatimi i ardhshëm mund të ketë ndikim madhor në ndryshimin e klimës. Duhet të merren parasysh çështjet e ndryshimit të klimës dhe menaxhimi i përgjithshëm i burimeve ujore.

Për ta bërë këtë, ky projekt do të integrojë kriteret e direktivës kuadër të ujit, WFD (2000/60/KE) në PZDS dhe programimin e investimeve. Për ta bërë këtë, planifikimi për këto direktiva specifike do të marrë në konsideratë menaxhimin e baseneve ujore, duke zvogëluar ndikimin e ndryshimeve klimatike, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe çështjeve të efikasitetit të ujit..

Konsulentit të projektit do t'i kërkohet të krijojë një sistem të menaxhimit të mjedisit për

[5] Përdorimi i udhëzimeve të Sida-s për integrimin gjinor, 2015.

projektin (ose të zbatojë një të tillë, nëse organizata e tij tashmë ka një sistem të njohur në zbatim) dhe ta paraqesë në raportin fillestar. Synimet dhe treguesit e performancës mjedisore do të duhet të miratohen.

Është kryer një VNM e thjeshtuar, në përputhje me Manualin e Gjelbër të Sida-s dhe mund të gjendet në shtojcën 1.

Varfëria dhe popullsia vulnerabël: ndryshimet në mjedis dhe klima kanë ndikimin më të madh te njerëzit që jetojnë në varfëri, njerëz, rezistenca e të cilëve ndaj ndryshimeve të tilla është shumë e dobët[6]. Një nga detyrat kryesore të Sida-s është të kontribuojë në një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm mjedisor. Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut, QBDN (e referuar si perspektiva e të drejtave në politikën suedeze) ofron një bazë ligjore dhe parime që udhëzojnë punën e Suedisë për njerëzit që jetojnë në varfëri.

Zbatimi i QBDN-së nga ana e Sida-s përfshin një fokus të të drejtave të njeriut që duhen arritur dhe mënyrën se si ta bëjë atë në një mënyrë që bazohet dhe çon në katër parimet e të drejtave të njeriut:

- mosdiskriminimi;
- pjesëmarrja;
- transparenca;
- llogaridhënia.

Ky propozim ka analizuar dhe integruar perspektivën e të drejtave në procesin e planifikimit. MNPI-ja e ujit ofron një mundësi për popullatat vulnerabël që të marrin pjesë në shërbimet publike të përmirësuara mjedisore në Shqipëri. Do të ketë 4 faza kur interesat e këtyre grupeve mund të integrohen:

1. Përgatitja e projektit. Ky propozim dhe termat e detajuar të referencës për prokurimin dhe kontraktimin vendosin standarde për dokumentet teknike që do të prodhojë projekti. Kjo do të bazohet në legjislacionin ekzistues të BE-së dhe Shqipërisë, por, gjithashtu, do të marrë parasysh edhe standardet që po përmirësohen. Për shembull, direktiva e ujit të pijshëm e BE-së (direktiva e Këshillit 98/83/KE) është në proces përditësimi për të reflektuar, mes çështjeve të tjera,

Sigurimin e aksesit në ujë për grupet vulnerabil dhe grupet e marzhinalizuara. Këto ndryshime janë gjithashtu në përputhje me agjendën 2030 dhe objektivin 6 të zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Konsultimi. Është parashikuar konsultim dhe pjesëmarrje e gjerë jodiskriminuese në aktivitetet e projektit dhe i është alokuar koha dhe buxheti brenda procesit të planifikimit[7]. Theks i veçantë vihet në identifikimin dhe përfshirjen e grupeve vulnerabil brenda programit të analizës dhe konsultimit të palëve të interesuara në lidhje me QBDN-në e Sida-s.

3. Vendosja e prioriteteve të investimeve. Tashmë është një objektiv i deklaruar i qeverisë shqiptare për të adresuar nevojat e të gjithë popullatës së Shqipërisë:

Sigurimi i një cilësie të sigurt, të besueshme, të mjaftueshme dhe të duhur të furnizimit me ujë për të gjithë popullsinë e Shqipërisë, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe rregullator.

dhe parimi udhëheqës i sektorit për barazinë:

Sigurohet qasje e barabartë në ujë, e përshtatshme si për nga sasia edhe nga cilësia, për të gjithë popullatën, veçanërisht për ata që vuajnë nga një disavantazh ose përjashtim shoqëror.

Misioni i Sektorit të Ujësjellësit dhe Kanalizimeve, Strategjia Kombëtare, 20 mars 2019. Ky mision për të përfshirë zonat më të varfra tashmë është duke u vënë në veprim përmes projekteve rurale të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

4. Analiza e përballueshmërisë. Kjo, gjithashtu, trajtohet në Strategjinë e Sektorit, te parimi i përballueshmërisë.

Ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët me një çmim të përballueshëm.

Do të ketë sfida për zhvillimin e planifikimit të investimeve për këtë sektor. Pritet që në përputhje me shtetet e tjera anëtare të BE-së, shumica e financimit të ujit do të vijë nga burimet e

[6] Manuali i Varfërisë (2017) dhe përmbledhja për ndryshimet mjedisore dhe klimatike (2015).

[7] Direktiva kuadër e ujit, gjithashtu, ofron udhëzime për konsultimin e dokumenteve kryesore.

BE-së, veçanërisht grante dhe në përgjithësi prioritete u janë dhënë atyre investimeve që kanë ndikimin më të madh dhe kërkohet rikuperim i plotë i kostos. Kjo normalisht do të thotë që përparësia për zbatimin e direktivës u jepet grupimeve më të mëdha. Financimi i MNPI-së së ujit dhe planifikimi i investimeve do të balancojnë këtë qasje ekzistuese me ndryshimet e mundshme në të ardhmen dhe do të rekomandojnë mënyrën sesi perspektiva e bazuar te të drejtat mund të reflektohet në zhvillimin e projekteve të besueshme.

Antikorrupsioni: institucioni i Koordinatorit Kombëtar Antikorrupsion është themeluar për të koordinuar aktivitetet antikorrupsion të qeverisë dhe institucioneve të pavarura në nivel qendror dhe vendor. Është krijuar një rrjet i pikave të kontaktit në të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura, të cilat monitorojnë dhe udhëzojnë zyrtarët përkatës në zbatimin e Strategjisë kundër Korrupsionit dhe raportojnë te Koordinatori Kombëtar Antikorrupsion. Organet kryesore parandaluese të korrupsionit në Shqipëri janë Task-Forca Antikorrupsion dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Komiteti Kombëtar i Antikorrupsionit kryesohet nga Ministria e Drejtësisë. Secili institucion ka një koordinator në secilën ministri. Pika e kontaktit në MIE është zëvendësministri, Hantin Bonati.

Kodi i Sjelljes për Nëpunësit Publikë, i miratuar nga Këshilli i Ministrave, mund të gjendet këtu (në shqip): https://www.drejtesia.gov.al/trego-fytyren-e-korrupsionit-2-2/.

9. Buxheti

Buxheti i propozuar është 20 milionë SEK/1,87 milionë euro. Buxheti i planifikimit propozon rreth 1.44 milionë euro tarifa dhe 0.24 milion euro kosto të rimbursueshme, si dhe auditimin dhe një fond kontigjence prej 5% për luhatjet e shkëmbimit valutor për t'u përdorur vetëm kur jepet moskundërshtimi nga Sida.

Ndarja e linjës së buxhetit të kostove të rimbursueshme është si më poshtë (e llogaritur):

Kostot e rimbursueshme	Njësitë	Kostot për njësi	Totali
Investigimet teknike, duke përfshirë testimin laboratorik jashtë vendit për llumrat dhe cilësinë e ujit.	1	€ 15,000	€ 15,000
Takimet konsultative – 3 për rezultatet 1, 3, 4, 5. Fazën e fillimi 3, rezultatet 2 dhe 6 (PZDS dhe ngritja e kapaciteteve) 4. Takimi mesatar 30 persona.	23	€ 1,500	€ 34,500
Trajnimet e jashtme për ngritje kapacitetesh, duke përfshirë certifikimin dhe udhëtimin. 1 trajnim në vit për 10 anëtarë të stafit = 2 trajnime secili. Kualifikimet ndërkombëtare të synuara për qëndrueshmërinë.	20	€ 5,000	€ 100,000
Vizitat studimore. 15 anëtarë që udhëtojnë.	30	€ 1,500	€ 45,000
Shërbime të jashtme të ekspertëve që nuk janë parashikuar në termat e referencës dhe ofertën financiare.	1	€ 20,000	€ 20,000
Të ndryshme: përkthimi i dokumenteve, përkthimi gjatë takimeve, dietat për stafin e ministrisë për aktivitetet e projektit, kur ato nuk mbulohen nga fondet kombëtare.	1	€ 25,000	€ 25,000
Totali			€ 239,500

10. Grafiku i veprimtarive

Periudha e zbatimit të projektit është llogaritur të zgjasë 27 muaj, duke filluar në vitin 2020.

Një grafik i përafërt kohor i veprimeve është paraqitur në figurën 1 më poshtë. Afatet kohore përfshijnë dorëzimin e të gjitha të dhënave të mbledhura, drafteve fillestare, konsultimeve, përditësimeve dhe drafteve përfundimtare.

	2019				**2020**				**2021**				**2022**			
	3m –1	**3m –2**	**3m –3**	**3m –4**	**3m –1**	**3m –2**	**3m –3**	**3m –4**	**3m–1**	**3m– 2**	**3m –3**	**3m –4**	**3m –1**	**3m –2**	**3m –3**	**3m –4**
Prokurimi – zhvillimi, reklamimi, vlerësimi dhe kontraktimi																
Faza e fillimit – mobilizimi, vlerësimi i të dhënave, përcaktimi i planit të punës, ngritja e strukturave të menaxhimit																
Rezultati 1: Grupimet, zonat sensitive, zonat ujore																
Rezultati 2: PZDS																
Rezultati 3: Strategjia e llumrave																
Rezultati 4: Programi i investimit																
Rezultati 5: Legjislacioni																
Rezultati 6: Ngritja e kapaciteteve																
Mbyllja e projektit																

Figura 3. Grafiku kohor tregues i projektit

11. Kuadri logjik

Planifikimi i aktiviteteve, burimeve dhe monitorimi ka ndjekur qasjen e kuadrit logjik:



11. Kuadri Logjik

Planifikimi i aktiviteteve, burimeve dhe monitorimi ka ndjekur qasjen e kuadrit logjik:

		Aktivitetet Kryesore	Inputet (min.)	Treguesit dhe verifikimi	Burimet e Verifikimit
Objektivi i Përgjithshëm	Objektivi i përgjithshëm i projektit është të zhvillojë aftësitë e planifikimit strategjik në Sektorin e Ujit për zbatimin e standardeve të BE-së.	Planifikimi Strategjik (afat gjatë) Mbështetje për Negociatat Planifikim Investimesh (afat mesëm) Ngritje kapacitetesh.	Buxheti i Projektit.	Treguesi i ndikimit: Investimet e projektit për ujë të pijshëm dhe ujërave të ndotura rriten duke iu referuar drejtpërdrejt përputhshmërisë me BE-në. Shqipëria merr periudhën e duhur dhe të arritshme të tranzicionit për DTUNU dhe DUP pas negociatave të pranimit.	Vlerësim Pas Fakteve (Ex-Post)
Rezultati 1	Raport i përgatitur për Grupimet e Identifikuara për Zonat e Ujit dhe Zonat e Furnizimit me Ujë dhe Zonat Sensitive	• Përcaktimi i metodologjisë; • Identifikimi i Grupimeve; • Identifikimi i Zonave Sensitive; • Identifikimi i Kufijve të Gryksëderdhjeve Bregdetare. • Identifikimi i Zonave të Furnizimit me Ujë.	• Ekspert i Sektorit të Ujit. • Ekspertizë për menaxhimin e ujërave bregdetare.	Treguesit e produktit: • Draftet raportit të dorëzuara në kohë. • Takimet konsultative të mbajtura. • Pranimi i raportit nga MIE. Rezultati: • Informacion nga PZDS rreth përdorimit të raportit.	Ecuria e PZDS bazuar në raportin e Rezultatit 1.
Rezultati 2	Zhvillimi i Planeve për zbatimin specifik të Direktivës për DTUNU dhe	• Përcaktimi i metodologjisë • Analiza e jo –konformiteteve (GAP); • Qasje Strategjike; • Masat e identifikuara; • Analiza e Kostove; • Qasja e Investimit; • Listë e Plotë masash të forta dhe të buta. • Periudha tranzitore e propozuar.	Përvoja e Përafrimit dhe Pranimit në BE. • Njohuri mbi Direktivën Kuadër të Mbetjeve. • Ekspert në nën-sektorin e ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotur	Produktet: • Draftet e PZDS të dorëzuara në kohë. • Takimet konsultative të mbajtura. • Pranimi i PZDS nga MIE. Rezultatet: • Komentet nga KE (afat gjatë).	Reagimet nga MIE, Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e Financave, Delegacioni i BE-së. Progres Reportet e procesit të Pranimit në BE

Shërbimi i Përkthimit Zyrtar, Ministria e Drejtësisë, Republika e Shqipërisë
Service des Traductions Officielles du Ministère de la Justice de la République d'Albanie
Republic of Albania, Ministry of Justice, Official Translations Service

PERKTHIM ZYRTAR TRADUCTION OFFICIELLE OFFICIAL TRANSLATION



Rezultati 4	Program i zhvilluar për furnizimin me ujë dhe mbledhjen dhe trajtimin e ujërave të ndotura 2021–2027 dhe 2028–2034	• Koordinim me masterplanin e ujit. • Politika dhe planifikimi financiar. • Vendosja e prioriteteve. • Vendosja e procedurave.	• Ekspertizë në planifikimin e infrastrukturës së ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura. • Specialist planifikimi financiar.	Produktet: • Draftet e dokumenteve të dorëzuara në kohë. • Takimet konsultative të mbajtura. • Pranimi i raportit nga MIE. Rezultatet: • Pranimi i programit nga institucione të tjera si AKUM. • Evidencë e përdorimit praktik të programimit p.sh.: planifikimi IPA.	Planifikimi i investimit nga BE IFN. Lista e projekteve në zhvillim.

		Aktivitetet Kryesore	Inputet (min.)	Treguesit dhe verifikimi	Burimet e Verifikimit
Rezultati 5	Legjislacioni i miratuar për të mundësuar përfundimin e transpozimit të Direktivës së Ujit të Pijshëm (DUP) dhe Direktiva e Trajtimit të Ujërave të Ndotura Urbane (DTUNU).	• Analiza e jo – konformiteteve (analiza GAP). • Hartimi i legjislacionit dhe akteve nënligjore. • Konsultimi. • Sigurimi i drafteve përfundimtare.	• Ekspert për legjislacionin e BE -së. • Ekspert ligjor Shqiptar.	Produktet: Dorëzimi i drafteve dhe pranimi i raportit përfundimtar. Rezultatet: Legjislacioni i kaluar nga parlamenti / VKM.	Pranimi i legjislacionit në parlament /VKM.
Rezultati 6	Një Plan i Zhvillimit të Kapaciteteve për të mbështetur zbatimin e PZDS-së.	• Përcaktimi i aftësive, njohurive dhe përvojës së kërkuar. • Krijimi i standardit bazë. • Analiza jo –konformiteteve (analiza GAP). • Propozimi i masave. • Zhvillimi i plan veprimit. • Zbatimi i mbështetjes për partnerët kyç.	• Ekspert instituciona l. • Ekspert mbi procesin e menaxhimit të projektit. Buxheti për shpenzime të rastit për: • Trajnimet dhe certifikimet e jashtme. • Pajisje të vogla. • Vizita studimore.	Produktet: • Draftet e planit të zhvillimit të dorëzuara dhe të pranuara. • Plani i zbatuar në formën e trajnimeve, vizitave studimore, pajisjeve. Rezultatet: • Kapacitetet e rritura (numri i investimeve) . • Kapacitetet e rritura (gama e funksioneve).	Intervista rreth ecurisë me palët kryesore të interesit.

Përfundimtar

SHTOJCË 1
MNPI E UJIT, VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS (E THJESHTUAR)
Maj 2019

Konteksti

VNM-ja e mëposhtme rishikon Projektin e Mbështetjes së Planifikimit të Investimeve dhe Negociatave të Sektorit të Ujit (MNPI e ujit) për Shqipërinë. VNM-ja u krye në maj të vitit 2019, si pjesë e procesit të zhvillimit të propozimit të projektit përmes dialogut ndërmjet përfituesit kryesor të projektit, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Ambasadës së Suedisë në Shqipëri dhe konsulentit të asistencës teknike, Brooks Hannas & Partners.

Situata aktuale në Shqipëri është se 78% e popullatës[8] kanë mbulim të furnizimit me ujë (por jo domosdoshmërisht me standardet e cilësisë ose besueshmërisë së BE-së) dhe 54% është e mbuluar nga rrjetet e kanalizimeve nga të cilat 11% trajtohen me një standard të pranuar. Rritja e popullsisë kombëtare nuk është e lartë (më pak se 1% në vit që nga viti 1995[9]), por popullsia urbane po rritet më shpejt (nga 42% në 1995, në mbi 53% në 2019). Përdorimi i ujit është shumë i lartë, një nga më të lartat në Evropë me 8.700m³ për frymë në vit në vitin 2017 për shkak të një shkalle të madhe paefektshmërie dhe humbjeve në sistemin e administrimit të ujërave.

Ka nevojë të konsiderueshme për të trajtuar standardet e furnizimit me ujë dhe menaxhimit të ujërave të ndotura për të kontribuar në qëndrueshmërinë mjedisore të Shqipërisë.

Standardet

Në vitin 2015, qeveria suedeze vendosi që veprimet e Sida-s do të bazohen në pesë perspektiva, njëra prej të cilave është ndryshimi i integruar i klimës dhe perspektiva e mjedisit.

Kjo VNM është realizuar sipas dokumenteve të Manualit të Gjelbër të Sida-s dhe veçanërisht udhëzimet për një vlerësim të thjeshtuar të ndikimit në mjedisi (gusht 2017), si dhe praktikat e përgjithshme të mira ndërkombëtare për VNM-të.

Një vlerësim i veçantë strategjik i mjedisit, por i lidhur me të, do të bëhet pjesë e përfundimit të masterplanit të shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura.

Aktivitetet e Projektit

MNPI-ja e ujit kryesisht do të përbëhet nga një kontratë shërbimi për të ofruar ndihmë teknike për MIE-n për rreth 3 vjet.

Aktivitetet e drejtpërdrejta të projektit për vlerësim përfshijnë:

- Transporti i ekspertëve dhe pjesëmarrësve të ministrisë në takime, udhëtime në terren dhe vizita studimore. Një pjesë e këtij transporti do të jetë udhëtimi ndërkombëtar ajror, pjesa tjetër e mbetur do të jetë me makinë.
- Mirëmbajtja e zyrës për një ekip prej rreth 4 personash në çdo kohë. Zyra do të merret me qira dhe me kushte normale.

Aktivitetet e tërthorta:

- MNPI-ja e ujit do të mbështesin MIE-n dhe institucionet e tjera të rëndësishme për të zhvilluar dokumente të planifikimit strategjik për sektorin e ujit. Synimet kombëtare janë përafrimi me standardet mjedisore të BE-së, të cilat janë standarde më të larta të administrimit të ujit sesa ato aktuale.

Ndikimi mjedisor

Kontributet pozitive:

- Aktiviteti kryesor i projektit (zhvillimi i PZDS-së) pritet të përmirësojë standardet mjedisore që paraqesin një qasje të strukturuar të planifikimit të investimeve që do të rrisë ndjeshëm financimin dhe zbatimin e standardeve më të larta.
- Ndikimi i projektit të përgjithshëm të MNPI-së të ujit do të jetë zvogëlimi i ndotjes së

[8] Burimi: Shërbimet Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime, Strategjia e Sektorit 2019–2030, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, GIZ dhe KfW, 2019.
[9] Burimi: Kombet e Bashkuara 2019.

burimeve të ujit, uji i pijshëm me cilësi më të mirë, zvogëlimi i emetimeve të gazra serë[10] (GHG) dhe përmirësimi i ndërgjegjësimit mjedisor brenda popullatës.

- Përfitimet e qëndrueshme për mjedisin të këtij projekti mund të përmirësohen, duke përfshirë perspektivën e direktivës kuadër të ujit në procesin e planifikimit. Në këtë mënyrë, ndryshimet klimaterike dhe çështjet e ndërgjegjësimit publik do të merren, gjithashtu, në konsideratë në zhvillimin e planifikimit të investimeve për ujërat e ndotura dhe ujin e pijshëm.
- MNPI-së së ujit u është dhënë përparësi për zhvillim sepse kanë ndikim mjaft të gjerë në komunitetet brenda Shqipërisë. Për shembull, çdo vendbanim me popullsi mbi 2000 banorë do të kërkojë trajtim të ujërave të ndotura sipas standardeve të BE-së. Ky nivel planifikimi i detajuar dhe afatgjatë nuk haset diku tjetër.

Ndikimet negative:

- Projekti bazohet në një kontratë shërbimi dhe si rrjedhojë, ndikimet kryesore negative do të lidhen me aktivitetet e drejtpërdrejta të ekipit të ekspertëve. Këto përfshijnë transportin, takimet dhe mirëmbajtjen e një zyre.
- Mirëmbajtja e zyrës: operacionet normale, të vogla të zyrës do të përdorin energji, burime natyrore dhe do të gjenerojnë mbetje. Nuk ka mundësi të blihet energji nga burime të rinovueshme nga rrjeti i energjisë elektrike. Hapësirat e zyrave në Tiranë variojnë dukshëm në drejtim të efikasitetit të energjisë. Shërbimet e administrimit të mbetjeve janë publike dhe standarde për të gjithë.
- Menaxhimi i eventeve: Projekti do të përfshijë konsultime të gjera me partnerët kryesorë dhe palët e interesuara. Në mënyrë të ngjashme me menaxhimin e zyrave, vendet ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme dhe ndikimi mjedisor nga furnizimet e pijeve freskuese gjithashtu mund të ndryshojnë.
- Transporti (lokal): pjesa më e madhe e transportit të projektit pritet të jetë brenda Tiranës. Do të ketë gjithashtu nevojë për të kryer udhëtime në terren për të rishikuar infrastrukturën mjedisore në pjesë të ndryshme të vendit. Brenda Tiranës ekziston një rrjet i mirëorganizuar i transportit publik, duke përfshirë edhe taksitë me energji elektrike. Jashtë Tiranës mundësitë janë shumë më të kufizuara.
- Transporti (ndërkombëtar): Projekti do të duhet të përdorë ekspertë me përvojë ndërkombëtare dhe mund të mbështesë vizita studimore si pjesë e aktiviteteve të kapacitetit dhe ngritjes së kapaciteteve. Aviacioni gjeneron një pjesë të lartë të GHG[11] në BE dhe në mbarë botën, por si një formë transporti e matur për person për km nuk është domosdoshmërish më negative se makinat[12].

Tabela 1. Përcaktimi i masës së riskut për MNPI-në e Ujit

Nr.	Risku +/-	Mundësitë për të ndodhur	Ndikimi	Pikët	Veprimet përmirësuese/lehtësuese
1	Arritja e objektivave të projektit: kontributet e planifikimit të investimeve kyçe (+)	5	5	25	Integrimi i direktivës kuadër të ujit në përgatitjen e planeve të tjera të direktivës.
2	Mirëmbajtja e zyrës (-)	5	2	10	Kërkimi i konsulentit për të krijuar politikën mjedisore, përfshirë menaxhimin e zyrës. Përfshirja e rishikimit të ecurisë së politikave në monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

[10] Ulja e GHG: Kryesisht përmes trajtimit të kontrolluar aerobik dhe anaerobik të ujërave të ndotura dhe grumbullimit të biogazit nga linjat e llumit.

[11] 3% e emetimeve GHG në BE, por 12% e të gjithë transportit, por duke u rritur më shumë se çdo formë tjetër transporti. Burimi:https://ec.europa.eu/clima/policies/transport/aviation_en.

[12] Llogaritja varet nga faktorë si numri i personave për automjet, topografia e rrugëve dhe automjeti i përdorur.

3	Menaxhimi i eventeve (-)	3	2	6	Si pjesë e politikës mjedisore, të gjitha eventet e menaxhuara ose të financuara përmes projektit duhet të marrin në konsideratë çështjet mjedisore. p.sh.: ulja e përdorimit të plastikës me një përdorim të vetëm, duke kërkuar standarde mjedisore nga vendet e takimeve/aktiviteteve.
3	Transporti lokal (-)	5	3	15	Si pjesë e kritereve mjedisore, vendosni politika për transport me ndikim më të ulët gjatë projektit. Promovoni përdorimin e transportit publik/të përbashkët, automjeteve me nivele të ulëta të emetimit të gazrave.
4	Transporti ndërkombëtar (-)	4	3	12	Përfshini si pjesë të politikës mjedisore, p.sh.: konsideroni përdorimin e shoqërive që kompensojnë me investime gjurmën e tyre të karbonit.

Shënime në tabelën e riskut:
Risqe: me ndikim pozitiv dhe negativ.
Pikët: 1-5, nga më e ulëta tek më e larta.

Menaxhimi i standardeve mjedisore

Veprimet lehtësues dhe përmirësuese që duhet të ndërmerren nga projekti duhet të përcaktohen më tej në lidhje me politikën mjedisore të projektit, proceset e përcaktuara për të realizuar atë politikë dhe matjen dhe raportimin e performancës mjedisore. Këta hapa duhet të planifikohen dhe kryhen në mënyrë të strukturuar dhe transparente.

Një qasje e mirëplanifikuar ndaj standardeve mjedisore rekomandohet nga Manuali i Gjelbër i Sida-s. Kërkesa e konsulentit do të jetë politika dhe masat zbatuese për të mbuluar të gjitha aktivitetet e projektit. MNPI-ja e ujit gjithashtu, potencialisht, mund t'u prezantojë partnerëve të projektit një mënyrë për t'iu qasur standardeve mjedisore që mund të zbatohen në projektet e ardhshme për të gjithë donatorët/IFN.

Qasja e strukturuar e konsulentit të projektit do të jetë pjesë e raportit fillestar. Kjo do të përcaktojë një bazë dhe tregues të qëndrueshmërisë së mjedisit për moskundërshtimin nga Sida dhe vlerësuesit e ardhshëm. Nëse kjo qasje shtrihet përtej projektit tek institucionet e tjera ofron një mundësi për të rritur përfitimet pozitive si më poshtë:

5	Menaxhimi i standardeve të projekteve mjedisore. (+)	4	4	16	Prezantimi i politikave, proceseve dhe masave të performancës për këtë projekt, si pjesë e ngritjes së kapaciteteve për palët e interesuara mund të inkurajojë përdorimin më të gjerë të praktikës së mirë. Duhet të alokohet stafi/buxheti i duhur për të mundësuar një zbatim të mirë.

Përfundimet

MNPI-ja e ujit është një mundësi për të bërë një hap të madh përpara në qëndrueshmërinë e mjedisit në Shqipëri. Kontributet e projektit mund të zvogëlojnë ndjeshëm ndotjen e ujit dhe emetimet e gazrave.

Në të njëjtën kohë, përfitimet mund të rriten. Qasjet integruese nga direktiva kuadër e ujit e BE-së (DKU), të cilat nuk ishin parashikuar fillimisht në propozim, mund të zvogëlojnë ndikimin e ndryshimeve klimaterike për një gjeneratë të projekteve të infrastrukturës mjedisore. Nivelet e larta të konsultimit të kërkuara nga DKU-ja, gjithashtu, do të jenë në përputhje me ndryshimet klimaterike dhe perspektivën e integruar të mjedisit të Sida-s.

Aktivitetet e projektit do të kenë ndikim negativ në mjedis. Kjo VNM ka shtjelluar mënyrat për të zvogëluar riskun. Përdorimi i standardeve mjedisore për projektin do të sigurojë një qasje të strukturuar për përcaktimin e politikës, proceseve dhe matjen e performancës.

Vlerësimi i kostos për projektin "Marrëveshjet mbi ujërat dhe politika e mbështetjes së investimeve"

Rezultati	Ditët e punës për ekspertët kryesorë	Shkalla mesatare e tarifës	Shuma
Zyra e projektit (muajt)	30	3000	€ 90,000
Periudha e përgjithshme e projektit ku përfshihet periudha fillestare dhe përmbyllëse			
KE1: Drejtuesi i ekipit	413	800	€ 330,000
NKE: Koordinatori i ekipit	550	300	€ 165,000
Periudha fillestare			
KE2: Ekspert i lartë ndërkombëtar i ujit	30	800	€ 24,000
KE3: Ekspert i lartë lokal	30	450	€ 13,500
Rezultati 1: Aglomeratet, zonat sensitive, zonat ujore			
KE2: Ekspert i lartë ndërkombëtar i ujit	45	800	€ 36,000
KE3: Ekspert i lartë lokal	80	450	€ 36,000
NKE: Ekspertizë e specialistit (STE, lokal i lartë): zonat bregdetare	50	450	€ 22,500
Rezultati 2: DSIPs (UWWTD/DWD)			
KE2: Ekspert i lartë ndërkombëtar i ujit	120	800	€ 96,000
KE3: Ekspert i lartë lokal	140	450	€ 63,000
KE5: Ekspert ekonomist dhe financiar	40	600	€ 24,000
NKEs ndërkombëtarë: WFD, DWD & UWWTD	40	800	€ 32,000
NKEs lokalë: WFD, DWD & UWWTD	60	450	€ 27,000
Rezultati 3: Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Mbetjeve			
KE4 ndërkombëtarë: Ekspert i mbetjeve	120	800	€ 96,000
NKE: Ekspert lokal i mbetjeve/WW proces	150	500	€ 75,000
KE5: Ekspert ekonomist dhe financiar	50	600	€ 30,000
NKEs – specialistë	50	500	€ 25,000
Rezultati 4: Programi i investimeve			
Menaxhuar nga TL			

KE5: Ekspert ekonomist dhe financiar	30	600	€ 18,000
KE3: Ekspert i lartë lokal	50	450	€ 22,500
Rezultati 5: Legjislacioni			
NKE: Ekspert i lartë ligjor kombëtar	120	450	€ 54,000
NKE: Ekspert ligjor ndërkombëtar	60	800	€ 48,000
Rezultati 6: Ndërtimi i kapaciteteve			
NKE ndërkombëtar: Ekspertë institucionalë	60	800	€ 48,000
NKE lokal të lartë: Trajner të brendshëm	140	450	€ 63,000
Tarifa e plotë			€ 1,438,500
të rimbursueshmet			€ 240,000
Verifikimi i auditimit/shpenzimeve	2	15000	€ 30,000
Nëntotal			€ 1,708,500
Të paparashikuara 5%/ (ose emergjenca)			€ 85,425
Totali			**€ 1,793,925**

Supozime:

Ekspertët ndërkombëtarë punojnë të paktën 80% të kohës së tyre në Shqipëri.

Kostot e udhëtimeve për ekspertët ndërkombëtarë janë 1 fluturim për 8 ditë punë me një kosto mesatare prej 300 €.

Dietat ditore përfshihen në koston e ekspertëve të jashtëm.

Zyra e Projektit përfshin të gjitha kostot që lidhen me mirëmbajtjen e zyrës së projektit për periudhën e projektit, duke përfshirë por jo duke u kufizuar në: qiranë, shërbimet, mobiliet, pajisjet e punës, automjetin/transportin, ndihmën e sekretarisë.

Emergjenca vetëm për përdorim pa asnjë kundërshtim të Sida-s. Synohet të balancojë luhatjet e mundshme të monedhës.

	2019				**2020**				**2021**				**2022**			
	Q1	**Q2**	**Q3**	**Q4**	**Q1**	**Q2**	**Q3**	**Q4**	**Q1**	**Q2**	**Q3**	**Q4**	**Q1**	**Q2**	**Q3**	**Q4**
Prokurimi – zhvillimi, reklamimi, vlerësimi dhe kontraktim**i**																
Faza fillestare – mobilizimi, vlerësimi i të dhënave, përcaktimi i planit të punës, krijimi i strukturave të menaxhimit.																
Rezultati 1: Aglomeratet, zonat e ndjeshme, zonat ujore																
Rezultati 2: DSIPs																
Rezultati 3: Strategjia e Mbetjeve																
Rezultati 4: Programi i investimeve																
Rezultati 5: Legjislacioni																

Rezultati 6: Ndërtimi i kapaciteteve																
Përfundimi i projektit																

Përbërja e ekipit	Rolet dhe përgjegjësitë
KE1: Drejtuesi i ekipit	Kontributet teknike për planifikimin strategjik, planifikimin e investimeve dhe ndërtimi i kapaciteteve. Gjithashtu menaxhimi i ekipit, personeli, kontrolli i cilësisë së rezultateve të STE, raportimi.
KE2: Ekspert i lartë ndërkombëtar i ujit	Inpute teknike në rezultatet 1 & 2
KE3: Ekspert i lartë kombëtar	Inpute teknike në rezultatet 1-6
KE4: Eksperti i mbetjeve	Udhëheqja dhe inputet teknike rezultati 3
KE5: Ekspert ekonomist dhe financiar	Inputet teknike për rezultatet 2, 3, 4
STEs: Ndërkombëtar	Ekspertizë speciale
STEs: Lokal të lartë	Ekspertizë speciale

Të rimbursueshmet	Njësitë	Kosto për njësi	Totali
Kërkimet teknike duke përfshirë testimin laboratorik jashtë vendit për mbetjet/llumrat dhe cilësinë e ujit.	1	€ 15,000	€ 15,000
Ngjarjet e këshillimit – 3 për rezultatet 1,3,4,5. fillimi 3, rezultatet 2 dhe 6 (DSIP dhe ndërtimi i kapaciteteve) 4. për event mesatarisht 30 persona.	23	€ 1,500	€ 34,500
Trajnime të jashtme për ndërtim kapacitetesh duke përfshirë certifikimin dhe udhëtimin. 1 trajnim në vit për 10 anëtarë të stafit = 2 trajnime secili. kualifikimet ndërkombëtare të synuara për qëndrueshmërinë.	20	€ 5,000	€ 100,000
Udhëtime studimi. 15 anëtarë për udhëtim.	30	€ 1,500	€ 45,000
Shërbime të jashtme të ekspertëve që nuk janë parashikuar në ToR dhe në ofertën financiare.	1	€ 20,000	€ 20,000
Të ndryshme: Përkthimi i dokumenteve, interpretimi, dietat për stafin e ministrisë për aktivitetet e projektit, kur ato nuk mbulohen nga fondet lokale	1	€ 25,000	€ 25,000
Totali			€ 239,500

Njësia e projektit AKUM (për diskutim)	Njësitë	Kosto për njësi	Totali
Mbështetje administrative, ekuivalent me 2 nëpunës të rinj	33	€ 1,500	€ 49,500
Mbështetje zyre, printim, udhëtim.	1	€20,000	€ 20,000
Totali			€ 69,500

Përmbledhja e kategorive të kostove	
Kontrata kryesore:	
Tarifat	1,438,500
Të rimbursueshmet	240,000
Verifikimi i auditit/kostos	30,000
Të paparashikuara 5%	85,425
Totali	1,793,925
Njësia e projektit AKUM	69,500
Buxheti i përgjithshëm i planifikimit	1,863,425

SHTOJCË C
TERMAT STANDARDË TË REFERENCËS SË SIDA-s PËR AUDITIMIN VJETOR TË MBËSHTETJES SË PROJEKTIT/PROGRAMIT

Shkrimi me ngjyrë të kuqe është tekst ndihmës dhe duhet të fshihet para se termat e referencës të vendosen si shtojcë te marrëveshja. Shkrimi me ngjyrë blu është tekst që duhet të zëvendësohet. Zëvendësoni [partneri i bashkëpunimit] me emrin e partnerit të bashkëpunimit, si dhe tekst tjetër që është në ngjyrë blu.

Hyrje

Prezantim i shkurtër i [partnerit të bashkëpunimit], në vijim i referuar si "Partneri i bashkëpunimit":

Partneri i bashkëpunimit dëshiron të angazhojë shërbimin e një firme audituese, me qëllim auditimin e [emri i projektit/programit], siç parashikohet në marrëveshjen ndërmjet partnerit të bashkëpunimit dhe Sida-s. Auditimi do të kryhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të lëshuara nga IAASB[13]. Auditimi kryhet nga një audituesi jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar.

I. Objektivat dhe fusha e veprimit e auditimit

Objektivi është auditimi i raportit financiar për periudhën [viti – muaji – dita – deri në viti – muaji – dita], siç është dorëzuar te Sida dhe shprehja e një opinioni auditimi sipas ISA 800/805, nëse raporti financiar i [emri i projektit/programit] është në përputhje me udhëzimet e Sida-s për raportimin financiar, siç parashikohet në marrëveshje, duke përfshirë shtojcën ndërmjet Sida-s dhe Partnerit të Bashkëpunimit.

II. Detyra shtesë; sipas procedurave ISRS 4400 të rëna dakord, rishikoni fushat e mëposhtme në përputhje me termat e referencës më poshtë

Renditni çdo fushë shtesë që do të inspektohet nga audituesi, p.sh.: ndjekja e pikave të dobëta të identifikuara në auditimet e mëparshme për efikasitetin ose inspektimet e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm. Vëreni që nëse buxheti përfshin kosto pagash që do t'i debitohen projektit/programit, gjithmonë duhet të ndiqen procedurat ISRS 4400 të rëna dakord (për informacion në lidhje me ISRS 4400 si standard, shihni Manualin e Auditimit) dhe të përfshijnë një pasqyrë që tregon nëse këto kosto janë regjistruar në një mënyrë të sistemuar që lejon ndjekjen e tyre. Madhësia e mostrës që audituesi do të inspektojë nën një detyrë shtesë në lidhje me dërgimin e fondeve duhet të specifikohet në termat e referencës ose në letrën e angazhimit ndërmjet audituesit dhe partnerit të bashkëpunimit.

Fushat e shqyrtimit më poshtë janë ndarë në detyra shtesë **të detyrueshme** dhe **opsionale**. Përveç këtyre, detyra të tjera shtesë mund të përfshihen gjithashtu bazuar në çka është e nevojshme dhe e rëndësishme në kontributin specifik. Konsultohuni me kontrolluesin tuaj në lidhje me fushat përkatëse të inspektimit.

Detyrat e detyrueshme që duhet të përfshihen:

1. Shihni nëse kostot e pagave të debituara për projektin/programin janë regjistruar gjatë gjithë kohëzgjatjes së vitit në një mënyrë të sistemuar dhe shqyrtoni nëse kostot e pagave mund të verifikohen nga një dokumentacion mbështetës i mjaftueshëm.

2. Shqyrtoni nëse raporti financiar përfshin një krahasim për çdo zë të buxhetit, midis kostove/shpenzimeve aktuale të aktiviteteve dhe kostove/shpenzimeve të buxhetuara, siç janë miratuar nga Sida për periudhën.

3. Bazuar në materialitetin dhe riskun, audituesi duhet të shqyrtojë nëse ka dokumentacion mbështetës në lidhje me kostot e realizuara. Pavarësisht nga materialiteti i gjetjeve, audituesi përcakton shumën për kostot që nuk kanë dokumentacion mbështetës të mjaftueshëm.

[13] Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë (IAASB).

4. Shqyrtoni nëse fitimet/humbjet e këmbimit valutor janë paraqitur si një zë i veçantë në raportin financiar, si dhe nëse janë paraqitur në përputhje me çka përcaktohet në marrëveshje, duke përfshirë shtojcat dhe parimet e kontabilitetit të pranuara gjerësisht.

5. Pajtueshmëria e partnerit të bashkëpunimit me legjislacionin e zbatueshëm të taksave në lidhje me taksat (p.sh. PAYE)[14] dhe tarifat e sigurimeve shoqërore.

6. Shqyrtoni nëse partneri i bashkëpunimit ka respektuar udhëzimet e prokurimit të vendosura si shtojcë ose të referuara në marrëveshje.

7. Shqyrtoni nëse bilanci dalës për periudhën e mëparshme është i njëjtë me bilancin hyrës për periudhën aktuale.

8. Nëse partneri i bashkëpunimit zbaton bazën e modifikuar të parave në dorë/parave të gatshme si parim kontabiliteti, audituesi duhet të përshkruajë metodën e përdorur dhe të arsyetojë nëse parimi i kontabilitetit të aplikuar është i pranueshëm për këtë lloj raporti financiar.

9. Verifikoni bilancin e pashpenzuar në fund të vitit financiar kundrejt regjistrave kontabël dhe dokumentacionit mbështetës.

10. Verifikoni bilancin e pashpenzuar që do t'i kthehet Sida-s në raportin përfundimtar të vitit të fundit të marrëveshjes. (E zbatueshme vetëm në raportin përfundimtar të vitit të fundit të marrëveshjes.)

Detyrat opsionale për t'u përfshirë në rastet kur është e zbatueshme:

- Shqyrtoni nëse partneri i bashkëpunimit ka zbatuar rekomandimet e mëposhtme nga vlerësimi i kontrollit të brendshëm: , dhe . Shqyrtimi përfshin inspektimin nëse partneri i bashkëpunimit ka zbatuar pikat e veprimit siç përshkruhen në përgjigjen e menaxhimit të partnerit të bashkëpunimit që i është dorëzuar Sida-s.
- Detyra të tjera shtesë?

III. Raportimi

Raportimi nënshkruhet nga audituesi përgjegjës (jo thjesht vetëm nga firma audituese) dhe përfshin titullin e audituesit përgjegjës.

Raportimi nga audituesi përfshin raportin e audituesit të pavarur në përputhje me formatin në standardin ISA 800/805 dhe opinion i audituesit duhet të shprehet qartë. Raporti i audituesit të pavarur përcakton qartë se auditimi është kryer në përputhje me ISA 800/805. Raportimi gjithashtu do të përfshijë një letër menaxhimi që paraqet të gjitha gjetjet e auditimit (gjetje të rëndësishme dhe të tjera), si dhe pikat e dobëta të identifikuara gjatë procesit të auditimit. Raporti financiar që ka qenë objekt i auditimit do t'i bashkëlidhet raportit të auditimit. Audituesi do të bëjë rekomandime për të trajtuar gjetjet dhe pikat e dobëta të identifikuara. Rekomandimet do të paraqiten sipas një rendi prioriteti.

Nëse audituesi vlerëson se nuk janë identifikuar gjetje ose pika të dobëta gjatë auditimit që do të rezultonin në një letër menaxhimi, në raportin e auditimit duhet të paraqitet një shpjegim i këtij vlerësimi.

Në letrën e menaxhimit do të paraqiten gjithashtu masat e marra nga organizata për të trajtuar pikat e dobëta të identifikuara në auditimet e mëparshme.

Detyra shtesë sipas procedurave të rënë dakord ISRS 4400 nën seksionin II do të raportohet veçmas në një "Raport të gjetjeve faktike". Madhësia e kampionit të raportimit të auditimit duhet të tregohet në raport.

Nëse audituesi kryen një detyrë shtesë sipas ISRS 4400 dhe vlerëson se vëzhgimet e paraqitura në "Raportin e gjetjeve faktike" përfshijnë informacionin që do të ishte përfshirë në një letër menaxhimi, nuk është e nevojshme të lëshohet një letër e veçantë menaxhimi për detyrën ISRS 4400. Përkundrazi, është e mjaftueshme nëse "Raporti i gjetjeve faktike" përfshin një shpjegim se pse nuk është lëshuar një letër menaxhimi.

[14] Paguani ndërsa fitoni.